



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



PLANIFIKIMI I BUXHETIT KOMUNAL PËR VITIN 2021

**Raport mbi procesin e planifikimit të buxhetit në komunat:
Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri,
Gjilan, Deçan, Junik, dhe Hani i Elezit**

Mars, 2021.



PLANIFIKIMI I BUXHETIT KOMUNAL PËR VITIN 2021

**Raport mbi procesin e planifikimit të buxhetit në komunat:
Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri,
Gjilan, Deçan, Junik, dhe Hani i Elezit**

Autor: Gzim Shala

Monitorues: Arrita Rezniki, Qëndrim Arifi, Arbenita Topalli

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është përgatitur nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO) me mbështetjen e USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse.

Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	8
2. Rreth projektit	11
3. Metodologjia	13
4. Baza ligjore në procesin e buxhetimit komunal.....	15
5. Profili i komunave të monitoruara.....	18
6. Përfshirja e qytetarëve në hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore	20
6.1. Konsulimi me shkrim dhe elektronik.....	20
6.2. Publikimi i njoftimit dhe Draft KAB-it në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike	21
6.3. Takimet publike për draftimin e KAB-it komunal.....	21
6.3.1. Numri i pjesëmarrësve dhe përfaqësimi gjinor në takimet publike gjatë draftimit të KAB-it.....	23
6.3.2. Pjesëmarrja e zyrtarëve kryesorë në takimet publike	24
6.4. Publikimi i raportit pas përfundimit të procesit të konsultimit publik	24
6.5. Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në KAB-in komunal.....	25
7. Përfshirja e qytetarëve në hartimin e buxhetit nga ekzekutivi komunal	26
7.1. Konsultimi me shkrim dhe elektronik	26
7.2. Publikimi i njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike	28
7.3. Dëgjimet buxhetore.....	29
7.3.1. Numri i dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga komunat.....	30
7.3.2. Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore.....	33
7.3.3. Përfaqësimi gjinor në dëgjimet buxhetore.....	36
7.3.4. Pjesëmarrja e zyrtarëve kryesorë në dëgjimet publike.....	36
7.4. Publikimi i raportit pas përfundimit të procesit të konsultimit publik	37
8. Dorëzimi i Propozim-Buxhetit Komunal në Kuvendin Komunal.....	38
9. Dëgjimet buxhetore gjatë shqyrtimit të buxhetit në kuvendet komunale	39
10. Miratimi dhe publikimi i buxhetit.....	41
11. Kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve në dëgjimet buxhetore	43
12. Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar të komunës	48
13. Gjetjet kryesore të IKD/INPO në procesin e buxhetimit komunal	51

14.	Rekomandime	54
15.	Shtojca I – Kërkesat e qytetarëve gjatë draftimit të KAB-it komunal, sipas vendbanimit dhe llojit	56
15.1.	Komuna e Hanit të Elezit	56
15.2.	Komuna e Junikut.....	57
16.	Shtojca II – Kërkesat buxhetore të qytetarëve sipas vendbanimit dhe llojit	60
16.1.	Komuna e Prishtinës.....	60
16.2.	Komuna e Gjakovës	62
16.3.	Komuna e Pejës	64
16.4.	Komuna e Gjilanit	66
16.5.	Komuna e Vushtrrisë	67
16.6.	Komuna e Rahovecit	72
16.7.	Komuna e Deçanit	75
16.8.	Komuna e Junikut.....	76
16.9.	Komuna e Hanit të Elezit	78
17.	Shtojca III – Komentet e komunave të cilat nuk janë përfshirë në raport.....	80
17.1.	Komuna e Hanit të Elezit	80
17.2.	Komuna e Gjakovës	81
17.3.	Komuna e Rahovecit	82

Lista e shkurtesave

IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
INPO	Iniciativa për Progres
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
MAP	Ministria e Administratës Publike
MPL	Ministria e Pushteti Lokal
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
UA	Udhëzim Administrativ

I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO) në kuadër të projektit “Kërkesa për Komuna Transparente dhe Llogaridhënese: Monitorimi i prokurimit publik dhe fuqizimi i qytetarëve për të sjellë ndryshime pozitive”, kanë monitoruar procesin e planifikimit buxhetor komunal për vitin 2021 dhe përfshirjen e qytetarëve gjatë këtij procesi në nëntë (9) komuna – Vushtrri, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Rahovec, Deçan, Junik dhe Han i Elezit. Me këtë rast, IKD dhe INPO kanë monitoruar në detaje procedurën e buxhetimit dhe standardet e aplikuara nga komunat në procesin e konsultimit publik për hartimin dhe miratimin e buxhetit.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komunat janë të obliguara që të zhvillojnë konsultime publike me rastin e hartimit të propozim-buxhetit për vitin e ardhshëm si dhe me rastin e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore. Sipas këtij udhëzimi, konsultimi me shkrim dhe elektronik, publikimi në ueb-faqen e komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime publike, si dhe së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara janë të obligueshme në procesin e konsultimit publik. Po ashtu, bazuar në këtë udhëzim administrativ, Komunat janë të obliguara që në fund të procesit të konsultimeve publike të publikojnë edhe një raport nga procesi i konsultimit publik.

Në rastin e konsultimeve publike gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, konsultimin me shkrim dhe atë elektronik si formë obligative e konsultimit publik nuk e ka zbatuar asnjë nga nëntë (9) komunat e monitoruara, derisa obligimin për të publikuar draft dokumentin, njoftimin për konsultime publike dhe adresën e dërgimit të komenteve në faqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultimeve publike e kanë përmbushur pjesërisht vetëm dy (2) komuna. Nga nëntë (9) komunat e monitoruara, katër (4) prej tyre kanë organizuar nga një takim publik gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, derisa këtë obligim nuk e kanë përmbushur pesë (5) komunat e tjera.

Ndërsa, sa i përket dëgjimeve buxhetore me rastin e hartimit të buxhetit nga ekzekutivi i komunës, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, katër (4) prej tyre nuk kanë organizuar dëgjime buxhetore, derisa dëgjime buxhetore kanë organizuar pesë (5) komunat e tjera. Disa prej këtyre komunave dëgjimet buxhetore i kanë mbajtur në mënyrë virtuale, për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike kërkon që edhe kuvendet komunale të mbajnë dëgjime publike pas pranimi të propozim-buxhetit nga ekzekutivi i komunave. Kuvendet komunale të nëntë (9) komunave të monitoruara nga IKD dhe INPO kanë mbajtur dëgjime buxhetore lidhur me Draft-Buxhetin Komunal, ku tetë (8) prej këtyre komunave, këto dëgjime buxhetore i kanë organizuar në bashkëpunim me IKD dhe INPO. Me qëllim të ngritjes së transparencës, të gjitha dëgjimet buxhetore të organizuara nga IKD dhe INPO, në bashkëpunim me komunat përkatëse, janë transmetuar drejtpërdrejt në rrjetin social “Facebook”. Përcjellja e këtyre dëgjimeve buxhetore nga ana e qytetarëve përmes faqes zyrtare të IKD-së dhe INPO-s në rrjetin social “Facebook”, ka variuar nga 2,400 deri në 13,000 shikime. Ndërsa, të gjitha dëgjimet buxhetore së bashku, kanë arritur rreth 63,000 shikime. Po ashtu, përpos qytetarëve që kanë qenë prezent në takim, edhe qytetarët që e kanë ndjekur

takimin përmes rrjetit social "Facebook" kanë pasur mundësi që të parashtrojnë pyetje dhe kërkesa buxhetore.

Lidhur me dëgjimet buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se sfida mbetet përfshirja e qytetarëve në këto dëgjime publike, që konsiston në numrin e vogël të qytetarëve që marrin pjesë në këtë formë të konsultimit publik. Dëgjimi publik me pjesëmarrjen më të lartë të qytetarëve është ai i organizuar nga Komuna e Pejës për fshatrat Qyshk, Bllagaj, Lutogllavë, Llabjan, Trestenik, Ruhot, Nabërgjan dhe Katundi i ri, në të cilin dëgjim kanë marrë pjesë gjithsej 39 qytetarë. Në rastin e Komunës së Prishtinës, në pesë (5) dëgjimet e organizuara buxhetore, në total kanë marrë pjesë vetëm tre (3) qytetarë. Përkatësisht, nga pesë (5) prej dëgjimeve buxhetore të organizuara nga Komuna e Prishtinës, në tri (3) prej tyre nuk ka pasur asnjë pjesëmarrës, në njërin dëgjim buxhetor kanë qenë prezent dy (2) qytetarë, derisa në një (1) dëgjim tjetër buxhetor ka qenë prezent vetëm një (1) qytetar. Po ashtu, IKD dhe INPO gjejnë se sfida e këtyre dëgjimeve buxhetore është përfaqësimi gjinor.

Megjithatë, përballë dëgjimeve buxhetore, shumica e komunave të monitoruara nuk qëndrojnë mirë sa i përket konsultimit me shkrim. Nga nëntë (9) komunat e monitoruara, IKD dhe INPO gjejnë se vetëm Komuna e Vushtrrisë ka zhvilluar procesin e konsultimit me shkrim gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2021.

Në të njëjtën kohë, problematike mbetet edhe publikimi i Draft-Buxhetit nga komunat e monitoruara. Publikimi i tij gjatë fazës së konsultimit publik lidhur me Draft-Buxhetin Komunal për vitin e ardhshëm mundëson ngritjen e cilësisë së këtyre konsultimeve, pasi qytetarët e kanë mundësinë që të shohin në parim si është ideuar Draft-Buxheti për vitin përkatës. Por, nga monitorimi i procesit të buxhetimit në nëntë (9) komunat përkatëse, IKD dhe INPO gjejnë se gjatë fazës së buxhetimit, vetëm Komuna e Hanit të Elezit ka publikuar Draft-Buxhetin.

IKD dhe INPO po ashtu kanë monitoruar edhe publikimin e raporteve të konsultimit, pas përfundimit të procesit të konsultimit publik për hartimin e buxhetit për vitin 2021. Me këtë rast, IKD dhe INPO gjejnë se përpos Komunës së Rahovecit e asaj të Gjakovës, asnjë prej komunave të tjera të monitoruara nuk e ka publikuar këtë raport.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kryetari i Komunës obligohet që deri më 1 shtator të vitit përkatës, t'ia dorëzoj Kryesuesit të Kuvendit Komunal buxhetin e propozuar për vitin pasues. Por, ky afat nuk ka pasur mundësi të zbatohet nga asnjë prej komunave të monitoruara. Kjo për arsye se gjashtë (6) ditë para arritjes së këtij afati, përkatësisht më 26 gusht 2020, Ministria e Financave i është drejtuar të gjithë kryetarëve të komunave me kërkesë për të mos proceduar me propozim-buxhetin komunal për vitin 2021. Kjo kërkesë arsyetohej me ndryshimin e rrethanave për shkak të pandemisë COVID-19. Në këtë mënyrë, kërkesa e Ministrisë së Financave e datës 26 gusht 2020 për mos procedim me Draft-Buxhetin Komunal deri në pranimin e qarkores buxhetore nga Ministria e Financave, e cila qarkore është dërguar nga kjo ministri më 14 shtator 2020, ka ngushtuar kohën e Kuvendeve Komunale për diskutim dhe shqyrtim të Draft-Buxhetit Komunal, përfshirë edhe vështirësitë e krijuara për Kuvendet Komunale në organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë.

Sa i përket përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në buxhetin komunal të miratuar nga komuna përkatëse, IKD dhe INPO gjejnë se shkalla e përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar është shumë e ulët, derisa është evidentuar një komunë, e cila në buxhetin e miratuar nuk ka përfshirë asnjë prej kërkesave të qytetarëve.

Lidhur me procesin e monitorimit të planifikimit të buxhetit, përveç aktiviteteve monitoruese që janë të shpjeguara më poshtë, IKD dhe INPO kanë realizuar një kampanjë informuese për të siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe qytetare dhe rrjedhimisht një proces sa më efektiv të monitorimit. Konkretisht, IKD dhe INPO kanë realizuar një video informuese drejtuar qytetarëve ku flitet për rëndësinë e një pjesëmarrje aktive në procesin e buxhetimit. Për më tepër, përmes kësaj video, u është bërë ftesë qytetarëve për pjesëmarrje në procesin e buxhetimit, duke i informuar edhe lidhur me mënyrat përmes të cilave ata mund të bëhen pjesë e vendimmarrjes. Kjo video është realizuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Përveç videos, qytetarët janë informuar edhe për oraret dhe mënyrat e dëgjimeve buxhetore përmes postimit të këtyre informatave në faqet e IKD dhe INPO.

2. Rreth projektit

Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e prokurimit publik në komunat në Kosovë, vazhdon të mbetet e brishtë. Përkundër faktit se legjislacioni në fuqi në fushën e prokurimit publik përmbush standardet e pranueshme për të zhvilluar aktivitetet e prokurimit publik duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, në praktikë vazhdimisht cënohen këto parime, përfshirë transparencën, llogaridhënien, mosdiskriminimin, integritetin etj.¹

Konkretisht ka probleme të vazhdueshme në lidhje me planifikimin e vlerës së kontratave publike; shkelje të ligjit në lidhje me afatet e tenderit; publikimi i njoftimeve publike (lidhur me proceset e prokurimit) me gabime thelbësore dhe teknike; nënshkrimi i kontratave publike pa specifikuar datën e përfundimit të kontratave; shkelja e vlefshmërisë së sigurimit të ekzekutimit të kontratës, etj. Për më tepër, komunat, në aktivitete të caktuara të prokurimit publik i kushtëzojnë operatorët me punësimin e ish-punonjësve të komunës.²

Punë e konsiderueshme duhet të bëhet për të parandaluar parregullsitë dhe korrupsionin gjatë fazës së prokurimit. Kosova duhet të adresojë kapacitetin e dobët të komunave për të administruar proceset e prokurimit publik, monitorimin e pamjaftueshëm, zbatimin e kontratave dhe sistemet e dobëta të mjeteve, të gjitha ato të cënueshme nga korrupsioni në rastin e prokurimit publik.

Andaj, përmes këtij projekti, IKD dhe INPO synojnë të adresojnë çështjet aktuale komplekse, siç u përmendën më lartë, me të cilat po përballet prokurimi publik i Kosovës në nivel komune dhe rrjedhimisht të përmirësohet objektiviteti, transparenca, llogaridhënia, në komunat e Kosovës, përmes monitorimit të proceseve të prokurimit publik, në nivel komune, si dhe duke siguruar pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proces, me fokus në nëntë komuna të zgjedhura: Vushtrri, Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Gjiilan, Junik, Deçan, Hani i Elezit dhe Rahovec.

Kjo bëhet përmes ekipit të ekspertëve, burimeve, si dhe përvojës së gjerë në këtë fushë, që është vënë në shërbim për aktivitetet e këtij projekti, duke realizuar një proces efektiv të monitorimit në nëntë komuna; duke fuqizuar qytetarinë aktive përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese, si dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në monitorimin e kontratave; duke adresuar gjetjet dhe rekomandimet tek institucionet e nivelit qendror; duke fuqizuar të sapodiplomuarit në drejtësi për të udhëhequr ndryshime pozitive në terren; duke promovuar praktika të mira të proceseve të prokurimit; dhe në fund duke rritur diskutimin, pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, OSHC-ve, dhe qytetarëve.

Pikërisht roli aktiv i qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile është një faktor kryesor për të siguruar institucione më transparente, efektive dhe llogaridhënëse. Sa më shumë që qytetarët dhe OSHC-të të ndërgjegjësohen dhe të fuqizohen rreth rolit aktiv që ata mund të luajnë në monitorimin e punës së institucioneve dhe zvogëlimin e korrupsionit, aq më të qëndrueshme janë rezultatet. Prandaj, IKD dhe INPO i kanë kushtuar fokus të madh sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në monitorimin e kontratave, në seanca të buxhetit, etj.

¹INPO në partneritet me IKD, “Prokurimi i “përligjur” në Komunat e Kosovës”, Prishtinë, 2019. f.8.

² Po aty, f.9.

Përveç kësaj, IKD dhe INPO kanë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese, ku qytetarët kanë mësuar më shumë rreth rolit të tyre në proces, si dhe për rëndësinë që ka përfshirja e tyre në zvogëlimin e korrupsionit në prokurimin publik.

Sa i përket rolit të qytetarëve, aktivitetet e projektit përfshijnë: sigurimin dhe lehtësimin e diskutimit ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur; duke siguruar që kërkesa e qytetarëve të përfshihet në procesin e planifikimit të prokurimit; promovimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve përmes veprimtarive të ndërgjegjësimit; sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në monitorimin e kontratave përmes vëzhgimeve, duke siguruar një kanal online ku qytetarët gjithmonë mund të adresojnë shqetësimet, problemet dhe pyetjet e tyre.

Për shkak të rrethanave të COVID-19, të gjitha aktivitetet e monitorimit të pjesëmarrjes së qytetarëve janë zhvilluar përmes platformave virtuale dhe metodave të tjera online.

Zbatimi i këtij projekti është realizuar në partneritet ndërmjet Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativës për Progres (INPO), të dyja organizata me përvojë të madhe në monitorimin e prokurimit publik.

INPO është organizatë e trajnuar nga USAID përmes aktivitetit për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse. Kurse, IKD në anën tjetër, ka një praktikë dhe përvojë të gjatë në monitorimin, identifikimin dhe kur është e nevojshme, zbulimin e rasteve të keqpërdorimeve dhe diskriminimit në aktivitetet e prokurimit publik, sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes një sistemi të fortë monitorimi dhe hulumtimi.

3. Metodologjia

Për qëllim të përmbushjes së objektivave të projektit dhe hartimit të një raporti sa më përmbajtësor, IKD dhe INPO fillimisht kanë realizuar një sërë aktiviteteve të parapara, duke filluar nga kryerja e një procesi gjashtë mujor të monitorimit të procedurave të prokurimit, në katër faza të ndryshme të zhvillimit të tyre, pastaj sigurimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në procesin e monitorimit, përmes formave online dhe atyre të drejtpërdrejta, zhvillimi i aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe avokimit, si dhe adresimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të procesit të monitorimit tek institucionet e nivelit qendror.

Lidhur me procesin e monitorimit të planifikimit të buxhetit, përveç aktiviteteve monitoruese që janë të shpjguara më poshtë, IKD dhe INPO kanë realizuar një kampanjë informuese për të siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe qytetare dhe rrjedhimisht një proces sa më efektiv të monitorimit. Konkretisht, IKD dhe INPO kanë realizuar një video informuese drejtuar qytetarëve, ku flitet për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në procesin e buxhetimit. Për më tepër, përmes kësaj video, u është bërë ftesë qytetarëve për pjesëmarrje në procesin e buxhetimit, duke i informuar edhe lidhur me mënyrat përmes të cilave ata mund të bëhen pjesë e vendimmarrjes. Kjo video është realizuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze³.

Përveç videos, qytetarët janë informuar edhe për oraret dhe mënyrat e dëgjimeve buxhetore përmes postimit të këtyre informatave në faqet e Facebook-ut të IKD-së dhe INPO-s. Proces i monitorimit lidhur me planifikimin e buxhetit, është zbatuar përmes pjesëmarrjes në dëgjime buxhetore, që për shkak të situatës së krijuar me COVID-19, pjesëmarrja është realizuar vetëm në dëgjimet buxhetore virtuale, kurse në rastet e tjera, monitorimi është bërë përmes procesverbaleve të takimit, të cilat procesverbale janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, të parashtruara në mbështetje të Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Para së gjithash, monitorimi është përqendruar tek përmbajtja ligjore që i referohet organizimit të konsultimeve publike me qytetarët gjatë fazës së hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe buxhetit komunal, derisa për çdo dëgjim/procesverbal të takimit, monitoruesit kanë plotësuar një formular monitorimi të dizajnuar vetëm për fazën e planifikimit të buxhetit. Në këtë formular, monitoruesit kanë plotësuar të dhënat që kanë të bëjnë me organizimin e dëgjimeve buxhetore, numrin e dëgjimeve buxhetore të organizuara nga komuna, datën dhe orën e dëgjimeve publike të organizuara nga komuna, nëse komunat i janë përmbajtur orarit të përcaktuar për dëgjime buxhetore, organizimin e këtyre dëgjimeve

³ Linku i videos në gjuhën shqipe:

https://www.facebook.com/275739927244/videos/244450833572080/?__so__=channel_tab&__rv__=all_videos_card; (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020).

Linku i videos në gjuhën serbe:

<https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/610067539678661/>; (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020).

Linku i videos në gjuhën angleze:

<https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/747996992710468/>; (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020).

buxhetore sipas lokalitetit apo temës së diskutimit, numrin e pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore, përfshirjen gjinore në dëgjimet buxhetore, zyrtarët komunal që kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore, prezantimin e Draft-Buxhetit Komunal nga Drejtoria e Financave dhe kërkesat e qytetarëve.

Procesi i monitorimit ka qenë i fokusuar në disa pika, si: plotësimi i obligimeve ligjore nga ana e komunave përgjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, pjesëmarrja e zyrtarëve komunalë në dëgjime buxhetore, përfaqësimi gjinor në dëgjime buxhetore, paraqitja ose jo me kohë e projekt buxhetit në kuvendet komunale, përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhet, praktikat e mira që mund të përdoren dhe çështje të tilla të ngjashme.

Më tutje, pas aprovimit të buxhetit nga ana e komunës, monitoruesit kanë evidentuar nëse kërkesat e qytetarëve (propozimet/ sugjerimet) janë përfshirë në buxhetin përfundimtar. Me këtë rast, monitoruesit e IKD dhe INPO kanë regjistruar secilën kërkesë të qytetarëve gjatë fazës së buxhetimit, dhe pas miratimit të buxhetit për vitin 2021 nga Komuna përkatëse, kanë analizuar buxhetin e miratuar dhe kanë kontrolluar nëse një kërkesë e caktuar është përfshirë apo jo në buxhetin e miratuar. Lidhur me këtë proces të identifikimit të këtyre kërkesave, me qëllim të saktësisë së të dhënave, IKD dhe INPO u kanë dhënë mundësi edhe komunave për të dhënë komentet e tyre, të cilat pastaj janë adresuar dhe përfshirë në këtë raport. Përveç kësaj, IKD dhe INPO në këtë raport kanë analizuar për nga aspekti krahasimor se sa prej projekteve të përfshira në buxhetin përfundimtar kanë të bëjnë me projekte kapitale për administratën komunale dhe sa prej tyre janë projekte që kanë të bëjnë me çështje të caktuara për lokalitete të ndryshme të komunave, si dhe sa prej projekteve janë të reja kundrejt atyre që janë vazhdim nga vitet e kaluara.

Në fund, të dhënat e mbledhura nga procesi direkt i monitorimit dhe të dhënat e siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike dhe informata (procesverbalet e dëgjimeve buxhetore, Draft-Buxhetet Komunale, për komunat që nuk i kanë publikuar këto të fundit në faqet e tyre zyrtare, informata nëse kuvendet komunale i kanë pranuar draft-buxhetet komunale me kohë etj.), të cilat si rrjedhojë e këtij procesi të monitorimit për secilën komunë, janë analizuar dhe kanë shërbyer për hartimin e këtij raporti.

Në fund, pas hartimit përfundimtar të raportit, i njëjti i është dërguar zyrtarëve përgjegjës në të gjitha nëntë (9) komunat e monitoruara, të cilat kanë pasur mundësi të paraqesin komentet e tyre përkitazi me përmbajtjen, gjegjësisht gjetjet e raportit dhe komentet eventuale të pranuar nga komunat janë adresuar në tërësi dhe janë përfshirë në këtë raport.

4. Baza ligjore në procesin e buxhetimit komunal

Ligji bazë për rregullimin e veprimtarisë së komunave, si nivel i dytë i qeverisjes, është Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Ky ligj ka përcaktuar se *“Komunat kanë buxhetet dhe financat e tyre për financimin e kompetencave të tyre⁴”* dhe se *“Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake; granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës; donacioneve dhe të hyrave të tjera”⁵*.

Procesit të hartimit të buxhetit komunal i paraprinë hartimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore. Neni 4.5.3. i Ligjit Nr. 05/L -063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se *“Divizioni i Buxhetit Komunal siguron mbështetje për komuna në përmbushjen e obligimeve të tyre të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe është i autorizuar dhe përgjegjës për “përgatitjen e pjesëzës së Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale si pjesë integrale e KASH-it”*.

Sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2021, Ministria e Financave dhe Transfereve përmes qarkores së lëshuar më 15 maj 2020, ka obliguar Komunat që të përgatisin dhe të aprovojnë këtë dokument deri më 30 qershor 2020⁶.

Procesi i hartimit dhe miratimit të buxhetit komunal është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili ligj ka po ashtu edhe pesë (5) plotësime/ndryshime.

Sipas këtij ligji, procedura e hartimit të buxhetit komunal për vitin e ardhshëm duhet të fillojë më së largu më 1 korrik të vitit paraprak. Kjo procedurë fillon nga Zyrtari Kryesor Financiar, i cili fillimisht duhet t’iu dërgojë të gjitha departamenteve komunale një qarkore buxhetore me udhëzimet e përcaktuara me ligj dhe duhet kërkojë, pranojë dhe shqyrtojë kërkesat buxhetore të të gjitha departamenteve komunale. Pas kësaj, Zyrtari Kryesor Financiar duhet të përgatisë propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm dhe të njëjtin t’ia dërgojë Kryetarit të Komunës⁷.

Pasi Kryetari i Komunës të miratojë propozim-buxhetin komunal, i njëjti obligohet që jo më larg se data 1 shtator e vitit përkatës, të dërgojë propozim-buxhetin komunal në Kuvendin Komunal⁸.

Ndërsa, Kuvendi Komunal i komunës përkatëse obligohet që të miratojë buxhetin për vitin e ardhshëm më së largu deri më 30 shtator të vitit paraprak, të cilin buxhet duhet ta procedojë në Ministri të Financave. Në lidhje me këtë, neni 61.2. i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se *“Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi*

⁴ Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Neni 24.1.

⁵Po aty. Neni 24.2.

⁶ Ministria e Financave dhe Transfereve. Qarkorja 2021/01. 15.05.2020. (Shih linkun <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/2E5DA770-1FB5-4DAD-85D7-7AE0FB53A905.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 28 janar 2021).

⁷Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 61.

⁸Po aty.

Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës. Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siç e sheh të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrit propozim-buxhetin Komunal”, derisa afati i përcaktuar në nenin 20.3 të këtij ligji, nen ky i riformuluar sipas Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, është data 30 shtator 2020. Në anën tjetër, sipas ligjit dhe akteve të tjera nën ligjore, procesi i hartimit dhe miratimit të buxhetit komunal duhet të përfshijë domosdoshmërisht edhe qytetarët, në mënyrë që në këtë proces të garantohet transparencë dhe gjithëpërfshirje. Për më tepër, një proces i tillë i buxhetimit mundëson identifikimin e prioriteteve dhe nevojave reale të qytetarëve të një komune, të cilat prioritete dhe nevoja duhet të reflektohen në buxhetin e miratuar.

Lidhur me procesin e konsultimit publik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka miratuar Udhëzimin Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Sipas nenit 6 të këtij udhëzimi administrativ, *“1.Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:.... 1.3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme; 1.2. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor”.*

Neni 10 i këtij udhëzimi administrativ përcakton format dhe teknikat e konsultimit publik. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton gjithsej 13 forma dhe teknika të konsultimit publik, derisa paragrafi 32 i po të njëjtit nen nënvizon se *“Konsultimi me shkrim dhe elektronik, publikimi në ueb-faqen e komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime publike, si dhe së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara janë të obligueshme në procesin e konsultimit publik”.*

Sa i përket mbajtjes së konsultimeve publike, neni 13 i këtij udhëzimi administrativ përcakton se *“Para aprovimit të një projekt propozimi, organi propozues vendos për hapjen e procesit të konsultimit publik”.* Në rastin konkret, konsultimin publik mbi Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe propozim-buxhetin sipas dispozitave të këtij udhëzimi administrativ duhet ta bëjë ekzekutivi i komunës përkatëse dhe këtë ta bëjë para se ta procedojë propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal të komunës përkatëse.

Pas përfundimit të konsultimeve publike mbi Kornizën Afatmesme Buxhetore, respektivisht buxhetin komunal, ekzekutivi i komunës përkatëse obligohet që të publikojë një raport mbi rezultatet e procesit të konsultimeve publike. Në këtë drejtim, neni 5.5. i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna përcakton se *“Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara”.*

Sa i përket buxhetit komunal, pasi që Kryetari i Komunës përkatëse procedon në propozim-buxhetin për vitin përkatës në Kuvendin Komunal, edhe Kuvendi Komunal obligohet që të mbajë dëgjime publike me qytetarët, para se ta miratojë propozim-buxhetin komunal.

Obligimi i kuvendeve komunale për të mbajtur dëgjime buxhetore para miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm është e rregulluar me dispozita ligjore. Në këtë rast, Ligji Nr. 03/L-048

për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se “*Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës*”. Në këtë mënyrë, dispozitat pozitive kanë obliguar institucionet komunale që procesin e hartimit dhe miratimit të buxhetit komunal për vitin përkatës ta bëjnë në konsultim me qytetarët, i cili bashkëpunim duhet të arrihet përmes procesit të konsultimit publik, në mënyrë që buxheti komunal të paraqesë prioritetet dhe nevojat reale të qytetarëve të një komune të caktuar. Sa i përket përfshirjes së qytetarëve në hartimin e politikave të komunave dhe transparencës së këtyre institucioneve, në fuqi është edhe Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, neni 6 i së cilës obligon komunat për transparencë financiare, derisa edhe Komunat e Republikës së Kosovës kanë miratuar rregullore që i referohen dhe kanë për qëllim ngritjen e transparencës.

5. Profili i komunave të monitoruara

IKD dhe INPO kanë monitoruar procesin e buxhetimit në nëntë (9) komuna, gjetjet e të cilit monitorim do të paraqiten në këtë raport.

Në vijim, janë paraqitur të dhënat kryesore mbi buxhetin e vitit 2021, për secilën nga nëntë komunat e monitoruara.

Në lidhje me komunat e monitoruara, buxhetin më të lartë komunal e ka Komuna e Prishtinës, derisa buxhetin më të ulët komunal e ka Komuna e Hanit të Elezit.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhëna mbi lartësinë e buxhetit dhe burimet përmes së cilave ndërtohet buxheti komunal:

Të dhënat lidhur me të hyrat buxhetore për komuna						
Komuna	Buxheti	Të hyrat vetanake	Granti i përgjithshëm	Granti për arsim	Granti për shëndetësi	Grante të tjera
Prishtinë	85,792,836 €	28,271,947 €	18,508,057€	21,108,027 €	6,950,006€	10,954,800 € (Ligji për Kryeqytetin)
Pejë	27,410,165 €	3,917,465€	9,810,724€	10,339,399 €	3,342,577€	/
Gjakovë	26,330,580 €	3,378,258€	9,415,942€	10,137,179 €	3,283,258€	115,943€ (Financimi për teatro)
Gjilan	27,734,737 €	4,048,034€.	8,616,947€	11,801,816 €	3,167,054€	100,886 € (Financimi i Teatrove)
Vushtrri	18,878,129 €	1,906,903€	6,709,131€	7,661,677€	2,425,419€	175,000 (Financimi i Shërbimeve të banimit)
Rahovec	14,216,590 €	1,061,093€	5,458,685€	5,745,764€	1,951,048€	/
Junik	1,546,704 €	122,802€	751,470€	427,885€	244,547 €	/
Deçan	9,942,300 €	646,165€	4,175,457€	3,730,296.08€	1,390,381€	/
Hani i Elezit	2,520,166 €	288,624 €	1,055,957 €	849,714 €	325,871 €	/

Tabela 1: Të dhënat lidhur me të hyrat buxhetore për komuna.

Sa i përket ndarjes së buxhetit komunal sipas kategorive të shpenzimeve, IKD dhe INPO gjejnë se në të gjitha komunat, kategoria më e lartë e shpenzimeve buxhetore i përket pagave dhe mëditjeve. Në tabelën në vijim, IKD dhe INPO kanë paraqitur të dhëna lidhur me buxhetin e nëntë (9) komunave përkatëse, sipas kategorive të shpenzimeve:

Ndarja e buxhetit komunal sipas kategorisë së shpenzimeve					
Komuna	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale
Prishtinë	31,000,000	20,100,000	2,100,000€	4,000,000€	28,592,836€
Pejë	14,813,275€	3,476,709€	748,455€	374,500€	7,847,226€
Gjakovë	14,150,978€	3,240,000€	586,800€	550,500€	7,802,302€
Gjilan	15,894,494€	4,112,000€	671,500€	790,000€	6,266,743€
Vushtrri	10,691,340€	3,218,600€	309,035€	600,000€	4,059,154€
Rahovec	7,622,634€	1,715,477€	280,500€	311,000€	4,281,979€
Junik	1,147,799€	172,900€	36,200€	30,500€	159,305€
Deçan	5,556,738€	1,582,859€	156,000€	140,000€	2,506,703€
Hani i Elezit	1,602,781€	335,258€	67,000€	75,000€	440,127€

Tabela 2: Ndarja e buxhetit komunal sipas kategorisë së shpenzimeve.

6. Përfshirja e qytetarëve në hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore

Gjatë procesit të monitorimit, IKD dhe INPO kanë gjetur se të gjitha komunat kanë miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Ndërsa, sa i përket përfshirjes së qytetarëve në draftimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, standardet minimale të konsultimit publik lidhur me draftimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore ngërthejnë obligimin e komunës përkatëse për të zbatuar të paktën (3) lloje të formave të konsultimit publik.

1. Konsultimi me shkrim dhe elektronik;
2. Publikimi në faqen zyrtare të komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike;
3. Së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara.

Në këtë drejtim, IKD dhe INPO kanë monitoruar zbatimin e këtyre obligimeve nga nëntë (9) komunat, të cilat si të ndara, janë të paraqitura në vijim.

6.1. Konsulimi me shkrim dhe elektronik

Sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organi propozues, ofron kushte për zhvillimin e konsultimit me shkrim dhe në formë elektronike, duke përfshirë informimin me kohë për mënyrat dhe afatet e konsultimit publik, derisa zyrtari përgjegjës për konsultim publik në koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projekt propozimit njofton palët e interesuara për konsultimin me shkrim dhe elektronik. Në nenin 15.3. të këtij udhëzimi administrativ përcaktohet se “Njoftimi me shkrim dhe elektronik, përmban:

- 3.1. Projekt propozimin për të cilin kërkohen komentet;
- 3.2. Adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet me shkrim dhe elektronike;
- 3.3. Informatat (emrin, mbiemrin dhe email-in) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve; dhe
- 3.4. Afatin për dorëzimin e komenteve”.

Ndërsa, paragrafi 4 dhe 5 i këtij neni përcakton se “Komuna obligohet të krijoj menu/rubrikë të veçantë brenda ueb-faqes zyrtare për procesin e konsultimit publik. Përmes ueb-faqes zyrtare dhe Platformës së Qeverisë për Konsultimet publike, komuna siguron shpalljen e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese, projekt propozimeve për konsultim, adresën për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik”.

Por, përkundër këtij obligimi të komunave, obligim ky që rrjedh nga Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, IKD dhe INPO kanë gjetur se asnjë prej komunave nuk kanë zhvilluar këtë formë të konsultimit publik gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se Komunat duhet t'i qasen me seriozitet dhe përkushtim obligimeve që rrjedhin nga ky udhëzim administrativ. Përkatësisht, IKD dhe INPO thekson faktin se dispozitat e këtij udhëzimi administrativ duhet të zbatohen në secilin dokument të komunës, të përcaktuar në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dhe, të paktën, sipas formave obligative të konsultimit publik, ndër të cilat është edhe konsultimi me shkrim dhe ai elektronik.

6.2. Publikimi i njoftimit dhe Draft KAB-it në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike

Sa i përket publikimit të njoftimit dhe Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike, formë kjo obligative e konsultimit publik në secilën komunë, IKD dhe INPO kanë gjetur se asnjë prej komunave të monitoruara nuk e ka zbatuar plotësisht këtë formë obligative të konsultimeve publike gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Përfundim në këtë rast bëjnë vetëm Komuna e Pejës dhe ajo e Rahovecit, të cilat e kanë zbatuar pjesërisht këtë obligim. Sa i përket Komunës së Pejës, e njëjta ka publikuar Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore, por jo edhe njoftimin për konsultime publike dhe adresën zyrtare për dërgimin e komenteve. Ndërsa, në rastin e Komunës së Rahovecit, kjo komunë ka publikuar Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore, si dhe njoftimin për konsultime publike, por se nuk ka publikuar adresën zyrtare për dërgimin e komenteve të qytetarëve përkitazi me këtë dokument.

6.3. Takimet publike për draftimin e KAB-it komunal

Njëra ndër format e konsultimeve publike gjatë hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, obligative për secilën komunë, është edhe mbajtja e të paktën një (1) takimit publik me qytetarët e komunës përkatëse.

Për dallim nga dy (2) format paraprake obligative të konsultimit publik, takimi publik gjatë fazës së draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore ka një nivel më të lartë të zbatimit nga ana e nëntë (9) komunave. Por se, pjesa më e madhe e komunave të monitoruara, nuk e kanë zbatuar as këtë formë të konsultimeve publike.

Përkatësisht, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, takim publik gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore kanë mbajtur katër (4) komuna, apo Komuna e Rahovecit, Pejës, Hanit të Elezit dhe Junikut.

Ndërsa, nga nëntë (9) komunat e monitoruara, këtë formë obligative të konsultimit publik gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore nuk e kanë zbatuar pesë (5) komuna, apo Komuna e Prishtinës, Gjiçanit, Gjakovës, Vushtrrisë dhe ajo e Deçanit.

Mbajtja e takimeve publike gjatë draftimit të KAB-it		
Komuna	Ka mbajtur dëgjime buxhetore	Nuk ka mbajtur dëgjime buxhetore
Prishtinë		X
Pejë	X	
Gjakovë		X
Gjilan		X
Vushtrri		X
Rahovec	X	
Deçan		X
Junik	X	
Hani i Elezit	X	

Tabela 3: Mbajtja e takimeve publike gjatë draftimit të KAB-it.

Sa i përket numrit të takimeve publike, të gjitha komunat të cilat kanë organizuar takime publike gjatë fazës së draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore kanë mbajtur nga një (1) takim publik me qytetarët. Po ashtu, këto takime publike nuk kanë qenë të ndara sipas temës së diskutimit apo lokalitetit, por se kanë qenë të hapura për të gjithë qytetarët.

Takimet publike të organizuara nga komunat gjatë draftimit të KAB-it		
Komuna	Data e mbajtjes	Ora e mbajtjes
Pejë	18.06.2020	12:00 ⁹
Rahovec	25.06.2020	14:00
Junik	03.06.2020	10:00
Hani i Elezit	15.06.2020	14:00-14:45

Tabela 4: Takimet publike të organizuara nga komunat gjatë draftimit të KAB-it.

⁹ Shënim: Në disa raste, procesverbalet e takimeve publike nuk e kanë specifikuar kohën kur kanë përfunduar takimet publike, por vetëm kohën se kur të njëjtat kanë filluar. Për këtë arsye, në raste të caktuara brenda kësaj tabele, figuron vetëm ora se kur ka filluar mbajtja e takimit publik.

6.3.1. Numri i pjesëmarrësve dhe përfaqësimi gjinor në takimet publike gjatë draftimit të KAB-it

Përkundër organizimit të takimeve publike, sfidë mbetet përfshirja e qytetarëve në këto takimeve publike. Kjo sfidë paraqitet në shumicën e dokumenteve publike të cilat në forma të ndryshme vihen në konsultim publik. Rrjedhimisht, kjo sfidë është paraqitur edhe në takimet publike të organizuara gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Sa i përket shkaktarëve që kanë ndikuar në pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në këto takime publike, IKD dhe INPO vlerësojnë se janë shkaktarët e njëjtë sikurse tek dëgjimet buxhetore për draftimin e buxhetit komunal, të cilët shkaktarë janë trajtuar në pjesën vijuese të raportit, dhe me qëllim të shmangies së përsëritjes nuk do të trajtohen këtu.

Sa i përket numrit të pjesëmarrësve në takimet publike të organizuara gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se numri më i madh i pjesëmarrësve ka qenë në takimin publik të organizuar nga Hani i Elezit, ku kanë marrë pjesë gjithsej 28 qytetarë, pasuar nga takimi publik i organizuar nga Komuna e Pejës me 22 qytetarë, ai i Rahovecit me 10 qytetarë dhe ai i Junikut me nëntë (9) qytetarë.

Në anën tjetër, përkundër sfidës së numrit të ulët të pjesëmarrjes së qytetarëve në këto takime publike, sfidë tjetër është edhe përfaqësimi gjinor në këto takime publike. Kjo pasi numri i grave pjesëmarrëse në këto takime publike është në disproporcion të hapur me numrin e burrave, derisa në rastin e Komunës së Rahovecit, nga 10 pjesëmarrës në takimin publik të organizuar gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, nuk ka qenë asnjë grua.

Në tabelën në vijim, janë paraqitur të dhëna të detajuara mbi pjesëmarrjen e qytetarëve dhe përfaqësimin gjinor në takimet publike të organizuara nga komunat e monitoruara gjatë fazës së draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore:

Numri i pjesëmarrësve dhe përfaqësimi gjinor në takimet publike të organizuara gjatë draftimit të KAB-it		
Burra 58		Gra 11
6	Junik 9 pjesëmarrës	3
10	Rahovec 10 pjesëmarrës	0
19	Pejë 22 pjesëmarrës	3
23	Hani i Elezit 28 pjesëmarrës	5

Tabela 5: Numri i pjesëmarrësve dhe përfaqësimi gjinor në takimet publike të organizuara gjatë draftimit të KAB-it.

6.3.2. Pjesëmarrja e zyrtarëve kryesorë në takimet publike

Ndër të tjera, IKD dhe INPO kanë monitoruar edhe pjesëmarrjen e zyrtarëve kryesor komunal në takimet publike të organizuara gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Me këtë rast, IKD dhe INPO gjejnë se Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në takimet publike të organizuara nga Komuna e Pejës, Junikut dhe Hanit të Elezit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal ka marrë pjesë në takimet publike të organizuara nga Komuna e Pejës dhe Rahovecit.

Ndërsa, në të gjitha takimet publike që komunat e monitoruara kanë organizuar gjatë fazës së draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, IKD dhe INPO kanë gjetur se ka marrë pjesë edhe Drejtori për Buxhet dhe Financa i komunës përkatëse.

6.4. Publikimi i raportit pas përfundimit të procesit të konsultimit publik

Neni 5.5. i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna përcakton obligimin e komunave që në fund të secilit proces të konsultimit publik të publikojnë edhe raportin e konsultimeve publike, në të cilin raport trajtohen rezultatet e procesit të konsultimit publik, propozimet e qytetarëve dhe arsyet për refuzimin e propozimeve të qytetarëve.

Nga nëntë (9) komunat e monitoruara, IKD dhe INPO gjejnë se këtë raport nuk e kanë publikuar tetë (8) komuna, derisa këtë raport e ka publikuar vetëm Komuna e Rahovecit, por se i njëjti raport nuk i përmbushë të gjitha kërkesat e nenit 5.5. të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, pasi ky raport flet për procesin e konsultimeve publike përkitazi me draftimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, por se nuk paraqet propozimet e qytetarëve dhe arsyet për refuzimin e propozimeve të qytetarëve¹⁰.

¹⁰ "Raporti për procedurat e ndjeura për mbajtjen e Debatit Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), për vitin fiskal 2021 dhe Vlerësimet e Hershme për vitet 2021-2023". Komuna e Rahovecit. 1 korrik 2020. (Shih linkun <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/12/Raport-per-procedurat-e-ndjekuara-per-mbajtjen-e-Debatit-Publik-per-Kornizen-Afatmesme-Buxhetore-KAB-per-vitin-fiskal-2021-dhe-Vleresimin-e-Hershe.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 29 janar 2021).

Publikimi i raporteve të konsultimit publik për draftimin e KAB-it		
Komuna	A është publikuar në faqe zyrtare?	A i përmbush kriteret e kërkuara?
Prishtinë	Jo	
Deçan	Jo	
Junik	Jo	
Gjilan	Jo	
Hani i Elezit	Jo	
Peje	Jo	
Gjakove	Jo	
Rahovec	Po	Pjesërisht
Vushtrri	Jo	

Tabela 6: Publikimi i raporteve të konsultimit publik për draftimin e KAB-it.

6.5. Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në KAB-in komunal

IKD dhe INPO kanë analizuar edhe përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në Kornizën Afatmesme Buxhetore të miratuar nga komuna përkatëse.

Sa i përket procesit të konsultimeve publike gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, siç u trajtua edhe më lartë, katër (4) nga nëntë (9) komunat e monitoruara kanë mbajtur takime publike. Në takimet publike të organizuara nga Komuna e Pejës dhe ajo e Rahovecit nuk janë parashtruar kërkesa të qytetarëve, derisa në takimet publike gjatë draftimit të KAB-it në Komunën e Hanit të Elezit janë parashtruar tetë (8) kërkesa, ndërsa në takimin publik të Komunës së Junikut janë parashtruar katër (4) kërkesa.

Në këtë mënyrë, IKD dhe INPO gjejnë se gjatë fazës së konsultimeve publike për draftimin e KAB-it komunal ka një numër të vogël të kërkesave. Në këtë fakt, ka ndikuar numri i vogël i takimeve publike që kanë organizuar komunat, si dhe numri jo i madh i qytetarëve që kanë marrë pjesë në këto takime publike.

Në anën tjetër, IKD dhe INPO gjejnë se kërkesat e qytetarëve kanë qenë shumë specifike, derisa të dhënat e paraqitura në KAB-in komunal kanë qenë të përgjithshme. Ky fakt ka ndikuar që të ketë kërkesa të caktuara të qytetarëve të cilat IKD dhe INPO nuk kanë pasur mundësi t'i vlerësojnë nëse të njëjtat janë përfshirë ose jo në KAB-in komunal.

Në tabelën në vijim, IKD dhe INPO kanë paraqitur të dhëna lidhur me numrin e kërkesave të qytetarëve dhe të dhëna lidhur me përfshirjen e këtyre kërkesave në KAB-in e miratuar nga komuna përkatëse.

Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në KAB					
Komuna	Nr. i kërkesave	Të përfshira	Pjesërisht të përfshira	Të përfshira pa	Nuk mund të identifikohet
Hani i Elezit	8	1	0	2	5
Junik	4	1	0	1	2

Tabela 7: Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në KAB.

7. Përfshirja e qytetarëve në hartimin e buxhetit nga ekzekutivi komunal

Sikurse në rastin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, standardet minimale të konsultimit publik lidhur me Draft-Buxhetin ngërthejnë obligimin e komunës përkatëse për të zbatuar të paktën (3) forma të konsultimit publik.

1. Konsultimi me shkrim dhe elektronik;
2. Publikimi në faqen zyrtare të komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike;
3. Së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara

Në këtë drejtim, IKD dhe INPO kanë monitoruar zbatimin e këtyre obligimeve nga nëntë (9) komunat, të cilat si të ndara, janë të paraqitura në vijim, ku takimeve publike konsultative (dëgjimeve buxhetore) i është bërë një trajtim më i detajuar.

7.1. Konsultimi me shkrim dhe elektronik

Konsultimi me shkrim dhe ai elektronik, si një nga standardet minimale të procesit të konsultimit publik me rastin e hartimit të Draft-Buxhetit është plotësisht i pazbatuar, me përjashtim të Komunës së Vushtrrisë, e cila ka zbatuar këtë formë të konsultimit.

Sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organi propozues, ofron kushte për zhvillimin e konsultimit me shkrim dhe në formë elektronike, duke përfshirë informimin me kohë për mënyrat dhe afatet e konsultimit publik, derisa zyrtari përgjegjës për konsultim publik në koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projekt propozimit njofton palët e interesuara për konsultimin me

shkrim dhe elektronik. Në nenin 15.3. të këtij udhëzimi administrativ përcaktohet se “Njoftimi me shkrim dhe elektronik, përmban:

3.1.Projekt propozimin për të cilin kërkohen komentet;

3.2.Adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet me shkrim dhe elektronike;

3.3.Informatat (emrin, mbiemrin dhe emailin) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve; dhe

3.4.Afatin për dorëzimin e komenteve”.

Ndërsa, paragrafi 4 dhe 5 i këtij neni përcakton se “Komuna obligohet të krijoj menu/rubrikë të veçantë brenda ueb-faqes zyrtare për procesin e konsultimit publik. Përmes ueb-faqes zyrtare dhe Platformës së Qeverisë për Konsultimet publike, komuna siguron shpalljen e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese, projekt propozimeve për konsultim, adresën për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik”.

Tabela në vijim e pasqyron aplikimin ose jo të konsultimit me shkrim dhe elektronik gjatë hartimit të buxhetit komunal nga nëntë (9) komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO:

Konsultimi me shkrim dhe elektronik gjatë hartimit të buxhetit komunal		
Komuna	Zbatuar	Pa zbatuar
Prishtinë		X
Pejë		X
Gjakovë		X
Gjilan		X
Vushtrri	X	
Rahovec		X
Deçan		X
Junik		X
Hani i Elezit		X

Tabela 8: Konsultimi me shkrim dhe elektronik gjatë hartimit të buxhetit komunal.

7.2. Publikimi i njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike

Procesi i konsultimeve publike përmes publikimit të njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare të komunës përkatëse dhe në platformën e konsultimeve publike vazhdon po ashtu të mbetet sfiduese për komunat.

Me këtë rast, nga monitorimi që IKD dhe INPO i ka bërë procesit të buxhetimit në komunat përkatëse, ka gjetur se nga nëntë (9) komunat e monitoruara, vetëm Komuna e Hanit të Elezit ka publikuar Draft-Buxhetin Komunal, para se të njëjtin ta procedojnë në Kuvendin Komunal.

Por, pjesa tjetër e këtij obligimi të procesit të hartimit të buxhetit komunal, publikimi i njoftimit dhe Draft-Buxhetit në platformën e konsultimeve publike nuk është zbatuar nga asnjëra nga komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO. Platforma online e konsultimeve publike siguron zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike. Kjo platformë ofron mundësinë që të gjitha palët të jenë të ftuara dhe të përfshira në procesin e konsultimit publik¹¹.

Publikimi i njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike		
Komuna	Publikimi në faqe zyrtare	Publikimi në platformën elektronike
Prishtinë	X	X
Pejë	X	X
Gjakovë	X	X
Gjilan	X	X
Vushtrri	X	X
Rahovec	X	X
Deçan	X	X
Junik	X	X
Hani i Elezit	✓	X

Tabela 9: Publikimi i njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike.

¹¹ Për më tepër, shih linkun <https://konsultimet.rks-gov.net/about.php>. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020).

7.3. Dëgjimet buxhetore

Njëra ndër format e konsultimeve publike gjatë hartimit të buxhetit komunal, obligative për secilën komunë, është edhe mbajtja e të paktën një (1) dëgjimi buxhetor me qytetarët e komunës përkatëse.

Kjo formë e konsultimit të qytetarëve është forma më e aplikuar nga ana e komunave me rastin e zhvillimit të konsultimeve publike gjatë procesit të hartimit të buxhetit komunal, por se gjatë monitorimit të procesit të buxhetimit, IKD dhe INPO ka gjetur edhe komuna të cilat nuk e kanë zbatuar këtë obligim.

Përkatësisht, nga nëntë (9) komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO, Komuna Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Rahovecit dhe Hanit të Elezit kanë mbajtur dëgjime buxhetore, derisa katër (4) komuna, përkatësisht, Komuna e Gjilanit, Vushtrrisë, Deçanit, dhe Junikut nuk e kanë zhvilluar këtë formë të konsultimeve publike me rastin e hartimit të buxhetit komunal.

Mbajtja e dëgjimeve buxhetore.		
Komuna	Ka mbajtur dëgjime buxhetore	Nuk ka mbajtur dëgjime buxhetore
Prishtinë	X	
Pejë	X	
Gjakovë	X	
Gjilan		X
Vushtrri		X
Rahovec	X	
Deçan		X
Junik		X
Hani i Elezit	X	

Tabela 10: Mbajtja e dëgjimeve buxhetore.

Sa i përket mënyrës së mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Gjakovës¹² dëgjimet buxhetore i kanë organizuar në mënyrë virtuale¹³.

Në vijim, IKD dhe INPO kanë paraqitur dhe analizuar në detaje dëgjimet buxhetore të komunave të monitoruara.

7.3.1. Numri i dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga komunat

Sa i përket pesë (5) komunave të cilat kanë mbajtur dëgjime buxhetore gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2021, më së paku dëgjime buxhetore ka mbajtur Komuna e Hanit të Elezit, e cila ka mbajtur një (1) dëgjim publik, derisa numrin më të madh të dëgjimeve publike e ka pasur Komuna e Rahovecit, e cila ka mbajtur gjithsej 15 dëgjime buxhetore. Komuna e Pejës ka organizuar gjithsej nëntë (9) dëgjime buxhetore, ajo e Gjakovës gjashtë (6) dëgjime buxhetore derisa Komuna e Prishtinës ka organizuar pesë (5) dëgjime buxhetore.

Sa i përket organizimit të këtyre dëgjimeve buxhetore, Komuna e Prishtinës dëgjimet buxhetore i ka ndarë sipas temës së diskutimit, Komuna e Pejës i ka organizuar sipas lokalitetit, kurse, ajo e Hanit të Elezit dëgjimin e vetëm buxhetor e ka organizuar si të hapur për të gjithë qytetarët. Kurse, Komuna e Gjakovës i ka mbajtur dëgjimet buxhetore sipas temës së diskutimit dhe po ashtu edhe të hapura, përderisa Komuna e Rahovecit dëgjimet buxhetore i ka organizuar sipas lokalitetit dhe po ashtu sipas temës së diskutimit.

Numri i dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga komunat		
Komuna	Numri i dëgjimeve publike	Sipas temës/lokalitetit
Prishtinë	5	Sipas temës së diskutimit
Pejë	9	Sipas lokalitetit
Gjakovë	6	Sipas temës së diskutimit dhe të hapura
Rahovec	15	Sipas temës së diskutimit dhe lokalitetit
Hani i Elezit	1	Të hapura

Tabela 11: Numri i dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga komunat.

¹² Shënim: Nga gjashtë (6) dëgjimet buxhetore, pesë (5) prej tyre Komuna e Gjakovës i ka mbajtur në mënyrë virtuale, derisa një (1) dëgjim buxhetor e ka organizuar në formë fizike.

¹³ Shënim: Me përkrahje të DEMOS-it, Komuna e Rahovecit ka filluar me mbajtjen e konsultimeve publike Online apo virtuale, takime të ngjashme do të mbehen edhe gjatë vitit 2021 nëse nuk i lehtëson masat Qeveria e Republikës së Kosovës. Përgjigje nga Komuna e Rahovecit për IKD dhe INPO. 13 janar 2021.

Në tabelën në vijim, IKD dhe INPO kanë paraqitur dëgjimet buxhetore të komunave të monitoruara sipas datës dhe orës së mbajtjes dhe sipas temës apo lokalitetit, për të cilin janë organizuar këto dëgjime buxhetore:

Dëgjimet buxhetore të organizuara nga komunat sipas orarit dhe temës apo lokalitetit			
Komuna	Data e mbajtjes	Ora e mbajtjes	Sipas temës së diskutimit/lokalitetit
Prishtinë	24.07.2020	10:14-10:35	Sipas temës së diskutimit: Identifikimi i kërkesave të sportistëve, rinisë dhe OJQ-ve për projektet e subvencioneve për planifikimin e buxhetit për vitin 2021
Prishtinë	25.07.2020	11:15-11:40	Sipas temës së diskutimit: Identifikimi i kërkesave të çerdheve, arsimit fillor dhe nevojave të nxënësve dhe prindërve për planifikimin e buxhetit për vitin 2021
Prishtinë	26.07.2020	10:05-11:40	Sipas temës së diskutimit: Identifikimi i kërkesave në sektorin primar shëndetësor dhe nevojave të tyre për planifikimin e buxhetit për vitin 2021
Prishtinë	27.07.2020	11:10-10:40	Sipas temës së diskutimit: Identifikimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve për planifikimin e buxhetit për vitin 2021
Prishtinë	28.07.2020	10:00-10:30	Sipas temës së diskutimit: Identifikimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve për planifikimin e buxhetit për vitin 2021
Pejë	17.08.2020	17:00 - 18:10	Sipas lokalitetit: Qyteti
Pejë	17.08.2020	18:30 - 19:30	Sipas lokalitetit: Fshatrat Zahaq, Ramun, Gllaviccicë, Leshan, Kliccinë dhe Jabllanicë e Leshanit

Pejë	18.08.2020	18:00 - 19:30	Sipas lokalitetit: Fshatrat Radavc, Novosellë, Jabllanicë e madhe dhe Jabllanicë e vogël
Pejë	19.08.2020	18:00 - 19:30	Sipas lokalitetit: Fshatrat Lugu i Baranit, Raushiq dhe Lybeniq
Pejë	20.08.2020	18:00 ¹⁴	Sipas lokalitetit: Fshatrat Vitomericë, Cigë dhe Brestovik
Pejë	21.08.2020	17:00	Sipas lokalitetit: Fshatrat Gorozhdec, Millavanc, Poqestë, Vragoc, Pishtan dhe Kerrstovc
Pejë	21.08.2020	18:30	Sipas lokalitetit: Fshatrat Loxhe, Llozhan, Doberdol dhe Grabovc
Pejë	24.08.2020	17:00 - 18:30	Sipas lokalitetit: Fshatrat e Rugovës
Pejë	24.08.2020	19:00 - 20:00	Sipas lokalitetit: Fshatrat Qyshk, PAvlan, Bllagaj, Lutogllavë, Llabjan, Trestenik, Ruhot, Nabërgjan dhe Katundi i Ri
Gjakovë	21.08.2020	10:00	Takim me Kryesuesit e Këshillave Lokalë
Gjakovë	24.08.2020	11:00 – 11:45	Të hapura ¹⁵
Gjakovë	25.08.2020	14:07-14:36	Të hapura
Gjakovë	26.08.2020	11:16 – 11:34	Të hapura
Gjakovë	27.08.2020	11:02-11:31	Të hapura
Gjakovë	28.08.2020	11:09-11:58	Të hapura
Rahovec	06.07.2020	19:00	Sipas lokalitetit: Fshatrat Krushë e Madhe, Celinë dhe Nagavc
Rahovec	06.07.2020	20:00	Sipas lokalitetit: Fshatrat Nagavc, Hoçë e Vogel dhe Brestoc

¹⁴ Shënim: Në disa raste, procesverbalet e dëgjimeve buxhetore nuk e kanë specifikuar kohën kur kanë përfunduar dëgjimet buxhetore, por vetëm kohën se kur të njëjtat kanë filluar. Për këtë arsye, në disa raste të kësaj tablele, figuron vetëm ora se kur ka filluar mbajtja e dëgjimit buxhetor.

¹⁵ Shënim: Dëgjimet buxhetore të hapura kanë kuptimin e dëgjimeve buxhetore të cilat nuk janë organizuar sipas lokalitetit apo temës së diskutimit, por kanë qenë të hapura për qytetarët në përgjithësi.

Rahovec	07.07.2020	19:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Malësi e Vogël dhe Gexhë
Rahovec	07.07.2020	20:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Ratkoc, Dejnë, Vrajak dhe Bratotin
Rahovec	08.07.2020	19:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Çifllak, Polluzhë dhe Dobidol
Rahovec	08.07.2020	20:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Kramovik, Guri i Kuq, Mrasor
Rahovec	09.07.2020	19:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Fortesë, Sapniq, Pataqan i Ulët dhe Pataqan i Epërm
Rahovec	09.07.2020	20:00	Sipas Lokalitetit: Xërxë
Rahovec	10.07.2020	18:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Drenoc, Pastasellë, Senoc, Zatriq, Kaznik dhe Nushpal
Rahovec	10.07.2020	18:00	Sipas Lokalitetit: Fshatrat Optreushë, Zoqisht, Retijë dhe Retij e Epërme
Rahovec	13.07.2020	15:00	Sipas temës: Buxhetimi gjinor i OJQ-ve
Rahovec	14.07.2020	16:00	Sipas temës: Bizneset
Rahovec	15.07.2020	15:00	Sipas lokalitetit: Fshati Hoçë e Madhe
Rahovec	15.07.2020	17:00	Sipas temës: Rinia
Rahovec	16.07.2020	19:00	Sipas Lokalitetit: Banorët e lagjeve I, II,III,IV dhe V të qytetit të Rahovecit
Hani i Elezit	26.08.2020	15:00-16:08	I hapur

Tabela 12: Dëgjimet buxhetore të organizuara nga komunat sipas orarit dhe temës apo lokalitetit.

7.3.2. Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore

Sa i përket dëgjimeve publike si formë e konsultimit publik për hartimin e buxhetit, si aspekt shumë sfidues evidentohet pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në këto dëgjime publike.

Duket se informimi jo i mjaftueshëm i publikut për të drejtën, mundësinë dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në fazën e buxhetimit është një prej arsyeve kryesore të pjesëmarrjes së ulët të

qytetarëve në këto dëgjime buxhetore. Me këtë rast, IKD dhe INPO vlerësojnë se kjo pamjaftueshmëri e publikut për këtë proces, duhet të adresohet në mënyrë institucionale dhe strategjike, për të informuar publikun mbi të drejtën, rëndësinë dhe mundësinë për pjesëmarrje në buxhetim.

Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në dëgjime të tilla publike e ul efektin e kërkuar nga kjo formë e konsultimit publik, duke e shndërruar një formë të konsultimit me karakter të përgjithshëm, në diskutim me një grup të vogël të qytetarëve.

Me këtë rast, krahas sfidave të tjerave, për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, disa prej komunave dëgjimet buxhetore i kanë mbajtur në mënyrë virtuale, i cili fakt, për shkak të vështirësive teknike për qasje, krahas të tjerave, ka ndikuar po ashtu në pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në këto dëgjime publike.

Për më tepër, IKD dhe INPO gjatë monitorimit të procesit të buxhetimit në nëntë (9) komuna kanë evidentuar tri (3) dëgjime buxhetore, në të cilat nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar.

Madje, numri i vogël i qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjimet buxhetore është pikërisht në kryeqytet. Numri i dëgjimeve buxhetore në këtë komunë është më i madh se sa numri total i qytetarëve që kanë marrë pjesë në këto dëgjime buxhetore.

Ndërsa, dëgjimi publik me pjesëmarrjen më të lartë të qytetarëve është ai i organizuar nga Komuna e Pejës për fshatrat Qyshk, Bllagaj, Lutogllavë, Llabjan, Trestenik, Ruhot, Nabërgjan dhe Katundi i ri, në të cilin dëgjim kanë marrë pjesë gjithsej 39 qytetarë.

Numri i qytetarëve pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore të mbajtura nga komunat			
Numri i dëgjimeve publike 36		Numri i qytetarëve pjesëmarrës në total 498	
5	Prishtinë	3	
1	Hani i Elezit	28	
6	Gjakovë	37	
15	Rahovec	165	
9	Pejë	265	

Tabela 13: Numri i qytetarëve pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore të mbajtura nga komunat. ¹⁶

¹⁶ Në listën e pjesëmarrësve në dëgjimin publik të Komunës së Hanit të Elezit për hartimin e projekt buxhetit për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2022-2023, janë të nënshkruar gjithsej 30 persona, mirëpo 2 nga ta kanë qenë zyrtarë të komunës. Meqë, në tabelë kemi paraqitur vetëm numrin e qytetarëve, aty i kemi identifikuar gjithsej 28.

Përkatësisht, nga pesë (5) dëgjimet buxhetore të organizuara nga Komuna e Prishtinës, në tri (3) prej tyre nuk kanë marrë pjesë asnjë qytetar, në një (1) dëgjim ka marrë pjesë vetëm një (1) qytetar dhe në një dëgjim tjetër buxhetor kanë marrë pjesë dy (2) qytetarë. Pra, në pesë (5) dëgjimet buxhetore, kanë marrë pjesë tre (3) qytetarë.

Në anën tjetër, në Komunën e Hanit të Elezit, e cila është komunë shumë më e vogël se sa ajo e Prishtinës, ka një numër relativisht më të madh të qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore, pasi në dëgjinin e vetëm buxhetor të organizuar nga kjo komunë kanë marrë pjesë 28 qytetarë.

Në këtë mënyrë, Komuna e Hanit të Elezit paraqet një progres në raport me komunat e tjera, kur kihet parasysh se është komunë më e vogël, por se numrin e qytetarëve në dëgjinin e vetëm buxhetor e ka më të madh. Bazuar në monitorimin e buxhetimit edhe të viteve të kaluara nga INPO është parë se vazhdimisht dëgjimet buxhetore të Hanit të Elezit kanë qenë më të suksesshme. Në raport me këtë komunë, shihet se janë dy (2) arsye kryesore që ndikojnë në ngritjen e numrit të pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore të Hanit të Elezit. Fillimisht, në këtë komunë vet komuniteti është më homogjen, në krahasim p.sh. me komunitetin e Komunës së Prishtinës. Në anën tjetër, tash e disa vite shihet se qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit tanimë kanë ndërtuar një raport dhe respekt me Komunën, përkatësisht me Kryetarin e Komunës, i cili ka treguar përkushtim në këtë drejtim, i cili raport është kultivuar ndër vite.

Në nëntë (9) dëgjimet buxhetore të organizuara nga Komuna e Pejës, numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në këto dëgjime publike varion nga 19 deri në 39. Mesatarisht, në këto dëgjime buxhetore, kanë marrë pjesë afërsisht 30 qytetarë.

Ndërkaq, numër i ulët i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore është shfaqur edhe në Komunën e Gjakovës. Në këtë komunë, ky numër varion nga një (1) një deri në 15 qytetarë. Shprehur në mesatare, i bie se në dëgjimet buxhetore të Komunës së Gjakovës, kanë marrë pjesë mesatarisht nga afërsisht 6 qytetarë.

Sa i përket Komunës së Rahovecit, e cila nga nëntë (9) komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO, ka mbajtur numrin më të madh të dëgjimeve buxhetore, numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore varion nga katër (4) deri në 22, derisa shprehur në mesatare, i bie se në të gjitha dëgjimet buxhetore kanë marrë pjesë mesatarisht nga rreth 11 qytetarë.

Me këtë rast, kjo gjetje e nxjerrë nga monitorimi që IKD dhe INPO u ka bërë këtyre komunave, paraqet faktin se dëgjimet buxhetore, si forma më e rëndësishme e konsultimeve publike në hartimin e buxhetit, nuk po shfrytëzohen sa duhet dhe si duhet. Kjo mungesë e shtrirjes së dëgjimeve publike ia humb kuptimin këtij organizimi, pasi më tepër paraqitet si takim me një grup të caktuar të qytetarëve, se sa me konsultim të tërësisë së qytetarëve, interesi i së cilës tërësi duhet të reflektohet në buxhetin e miratuar. Për këtë arsye, IKD dhe INPO konsiderojnë se të gjitha komunat dhe institucionet e tjera qendrore, duhet të apelojnë tek qytetarët, në drejtim të informimit të tyre për të drejtën dhe mundësinë për të marrë pjesë në këto forma të konsultimeve publike, duke pasqyruar edhe rëndësinë e kësaj

pjesëmarrje. Përtej kësaj, marrja parasysh e kërkesave të qytetarëve përçon mesazhin se qytetarët mund të jenë pjesë aktive e vendimmarrjes.

7.3.3. Përfaqësimi gjinor në dëgjimet buxhetore

Sa i përket përfaqësimit gjinor të pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se ka një disbalancë të theksuar gjinore. Kjo pasi nga struktura gjinore e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore, shihet se shumica dërrmuese e pjesëmarrësve janë burra dhe vetëm një numër i kufizuar i pjesëmarrësve janë gra. Nga të gjithë pjesëmarrësit në dëgjimet buxhetore në komunat e monitoruara, të cilat kanë mbajtur dëgjime buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se numri i pjesëmarrësve burra është mbi gjashtë (6) fish më i lartë se sa numri i pjesëmarrësve gra. Përkatësisht, nga të gjithë pjesëmarrësit në këto dëgjime buxhetore, 428 kanë qenë burra, derisa vetëm 70 kanë qenë gra.



Tabela 14: Përfaqësimi gjinor në dëgjimet buxhetore.

7.3.4. Pjesëmarrja e zyrtarëve kryesorë në dëgjimet publike

Krahas të tjerave, IKD dhe INPO kanë monitoruar edhe pjesëmarrjen e zyrtarëve kryesorë komunal në dëgjimet buxhetore.

Me këtë rast, IKD dhe INPO kanë gjetur se Kryetari i Komunës ka marrë pjesë vetëm në dëgjimet buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit, derisa nënkryetari i Komunës ka marrë pjesë në dëgjimet buxhetore të Komunës së Pejës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal ka marrë pjesë në dëgjimet buxhetore të Komunës së Pejës, Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Hanit të Elezit. Po ashtu, në Komunën e Rahovecit kanë marrë pjesë edhe anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ndërsa, Drejtori për Buxhet dhe Financa ka marrë pjesë në secilin dëgjim buxhetor të organizuar nga komunat, përkatësisht në dëgjimet buxhetore të organizuara nga Komuna e Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Rahovecit dhe Hanit të Elezit.

7.4. Publikimi i raportit pas përfundimit të procesit të konsultimit publik

IKD dhe INPO gjatë monitorimit të procesit të buxhetimit në nëntë (9) komunat përkatëse, ka monitoruar edhe publikimin e raporteve të konsultimeve nga ana e ekzekutivit të komunës përkatëse, pas përfundimit të procesit të konsultimit publik për hartimin e Draft-Buxhetit për vitin 2021.

Lidhur me këtë obligim, IKD dhe INPO gjejnë se vetëm Komuna e Rahovecit¹⁷ dhe Komuna e Gjakovës¹⁸ ka publikuar këtë raport, i cili raport i përmban pjesërisht kërkesat e përcaktuara në nenin 5.5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Këto dy (2) komuna kanë përmbushur pjesërisht këtë obligim për faktin se në raportet e tyre kanë përfshirë të dhënat lidhur me procesin e konsultimit publik dhe propozimet e ofruara nga qytetarët, por jo edhe për arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve. Ndërsa, këtë obligim nuk e ka përmbushur Komuna e Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Vushtrrisë, Deçanit, Junikut dhe Hanit të Elezit.

Publikimi i raporteve të konsultimit publik		
Komuna	A është publikuar në faqe zyrtare?	A i përmbush kriteret e kërkuara?
Prishtinë	Jo	/
Deçan	Jo	/
Junik	Jo	/
Gjilan	Jo	/
Hani i Elezit	Jo	/
Peje	Jo	/
Gjakove	Po	Pjesërisht

¹⁷ "Raporti i shkurtë mbi procedurat e ndjekura për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2021". Komuna e Gjakovës. 17 korrik 2020. (Shih linkun <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/08/Raporti-i-shkurter-mbi-procedurat-e-ndjekura-per-organizimin-e-degjimeve-publike-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit-2021-3.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 21 dhjetor 2020).

¹⁸ "RAPORTI dëgjimeve publike për Buxhetin e vitit 2021 – 2023 të komunës së Gjakovës me qytetarët e Komunës së Gjakovës". Komuna e Gjakovës. (Shih linkun <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/09/Degjimet-buxhetore-2021-Procesverbali.docx>). (Qasur për herë të fundit më 21 dhjetor 2020).

Rahovec	Po	Pjesërisht
Vushtrri	Jo	/

Tabela 15: Publikimi i raporteve të konsultimit publik.

8. Dorëzimi i Propozim-Buxhetit Komunal në Kuvendin Komunal

Sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kryetari i Komunës obligohet që deri më 1 shtator të vitit përkatës, t'ia dorëzojë Kryesuesit të Kuvendit Komunal buxhetin e propozuar për vitin pasues. Por, ky afat nuk është zbatuar në asnjë prej komunave. Kjo për arsye se gjashtë (6) ditë para arritjes së këtij afati, përkatësisht më 26 gusht 2020, Ministria e Financave i është drejtuar të gjithë kryetarëve të komunave me kërkesë për të mos proceduar me Propozim-Buxhetin Komunal për vitin 2021.

Kjo kërkesë arsyetohej me faktin se që nga fillimi i vitit 2020, vendi është përballur me pandeminë COVID-19 dhe si rezultat i kësaj, ka rënie të të hyrave buxhetore për vitin 2020. Për këtë arsye, kjo kërkesë nënvizonte faktin se është e nevojshme që të rishikohet financimi komunal për vitin 2021-2023, për të cilin fakt, u është kërkuar kryetarëve të komunave që të mos procedohet me dërgimin e Propozim-Buxhetit Komunal derisa nga Ministria e Financave të pranohet Qarkorja Buxhetore Komunale për vitet 2021-2023.

Kjo qarkore buxhetore u është dorëzuar kryetarëve të komunave nga Ministria e Financave më 14 shtator 2020, pas së cilës datë, Kryetarët e Komunave kanë proceduar me procedurat e buxhetimit dhe kanë përcjellë propozim-buxhetin tek kryesuesit e kuvendeve komunale.

Në tabelën në vijim, IKD dhe INPO kanë paraqitur datat e dorëzimit të Draft-Buxheteve Komunale tek Kryesuesit e Kuvendeve Komunale:

Data e pranimit të Draft-Buxhetit Komunal nga Kryesuesit e Kuvendeve Komunale	
Komuna	Data e dorëzimit të Draft-Buxhetit Komunal tek Kryesuesi i Kuvendit
Prishtinë	/ ¹⁹
Pejë	18 shtator 2020
Gjakovë	16 shtator 2020
Gjilan	21 shtator 2020
Vushtrri	21 shtator 2020

¹⁹ Shënim: Anëtarët e Kuvendit Komunal e kanë pranuar Draft-Buxhetin më 29 shtator 2020, por se Komuna e Prishtinës nuk ka ofruar informata se kur është pranuar Draft-Buxheti.

Rahovec	08 shtator 2020
Junik	24 shtator 2020
Deçan	15 shtator 2020
Hani i Elezit	21 shtator 2020

Tabela 16: Data e pranimit të Draft-Buxhetit Komunal nga Kryesuesit e Kuvendeve Komunale.

Në këtë mënyrë, kërkesa e Ministrisë së Financave e datës 26 gusht 2020 për mos procedim me Draft-Buxhetin Komunal deri në pranimin e qarkores buxhetore nga Ministria e Financave, e cila qarkore është dërguar nga kjo ministri më 14 shtator 2020, ka ngushtuar kohën e kuvendeve komunale për diskutim dhe shqyrtim të Draft-Buxhetit Komunal, përfshirë edhe vështirësitë e krijuara për Kuvendet Komunale në organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë.

Fillimisht, ky fakt ka ndikuar në ngushtimin e periudhës kohore për diskutim dhe shqyrtim të Draft-Buxhetit nga kuvendet komunale, për arsye se kuvendet komunale kanë afat ligjor deri më 30 shtator për miratimin e buxhetit komunal. Po ashtu ka ndikuar negativisht edhe në cilësinë e dëgjimeve buxhetore të organizuara nga kuvendet komunale. Kjo pasi që në disa raste, Draft-Buxheti nuk ka qenë në dispozicion, në momentin e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, për të cilën arsye, akterët komunal e kanë pasur të pamundur të paraqesin Draft-Buxhetin Komunal, në mungesë të së cilit, janë paraqitur të dhëna nga qarkoret buxhetore. Kjo problematikë është shfaqur në Komunën e Prishtinës, Deçanit, Junikut dhe asaj të Gjilanit.

Për më tepër, në rastin e Komunës së Prishtinës, kjo kërkesë e Ministrisë së Financave ka ndikuar po ashtu që kjo komunë të miratojë buxhetin komunal pas përfundimit të afatit të përcaktuar me ligj.

9. Dëgjimet buxhetore gjatë shqyrtimit të buxhetit në kuvendet komunale

Detyrimi i kuvendeve komunale për të mbajtur dëgjime buxhetore pas pranimit të propozim-buxhetit nga ekzekutivi komunal është obligim ligjor.

Në këtë drejtim, neni 61.2. i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se *“Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës. Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siç e sheh të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t’ia dorëzojë Ministrisë propozim-buxhetin Komunal”*.

Me këtë rast, për dallim nga ekzekutivi i komunave, kuvendet komunale të nëntë (9) komunave të monitoruara nga IKD dhe INPO kanë mbajtur dëgjime buxhetore lidhur me Draft- Buxhetin

Komunal, ku tetë (8) prej këtyre komunave, këto dëgjime buxhetore i kanë organizuar në bashkëpunim me IKD dhe INPO.

Në kuadër të projektit, IKD dhe INPO në bashkëpunim me kuvendet komunale kanë organizuar dëgjime buxhetore në të gjitha komunat e monitoruara, përjashtimisht Komunës së Hanit të Elezit, Kuvendi Komunal i së cilës komunë ka organizuar dëgjime buxhetore pa përkrahje të IKD dhe INPO.

Për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19, IKD dhe INPO në bashkëpunim me komunat e monitoruara, dëgimet buxhetore i kanë organizuar në mënyrë virtuale, përmes platformës “ZOOM”.

Me qëllim të ngritjes së transparencës dhe përfshirjes maksimale të qytetarëve, të gjitha dëgimet buxhetore të organizuara nga IKD dhe INPO, në bashkëpunim me komunat përkatëse, janë transmetuar drejtpërdrejt në faqet zyrtare të IKD dhe INPO, në rrjetin social “Facebook”²⁰.

Ndjekja e këtyre dëgjimeve buxhetore nga qytetarët përmes rrjetit social “Facebook” ka variuar nga 2,400 deri në 13,000 shikime. Ndërsa, të gjitha dëgimet buxhetore së bashku, kanë arritur rreth 63,000 shikime.

Në këto dëgjime buxhetore, kanë marrë pjesë përfaqësues të komunave përkatëse, si kryesuesit e kuvendeve komunale, kryetarë të komunave, përfaqësues nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës përkatëse, drejtorë komunal, qytetarë etj.

Dëgimet publike në secilin rast kanë filluar me elaborimin e propozim-buxhetit të komunës përkatëse për vitin 2021, ku pjesëmarrësit e dëgjimit publik dhe qytetarët e tjerë që kanë ndjekur këto dëgjime buxhetore, kanë pasur mundësi që të njoftohen lidhur me propozim-buxhetin e komunës përkatëse për vitin 2021.

²⁰ Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun https://www.facebook.com/275739927244/videos/335068604498932/?_so=_channel_tab&_rv=_all_videos_card. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun https://www.facebook.com/275739927244/videos/643608919600362/?_so=_channel_tab&_rv=_all_videos_card. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Pejës me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun <https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/1268678936808821/>. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Junikut me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun <https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/832658400902875/>. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Deçanit me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun <https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/3280106792027102/>. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun https://www.facebook.com/275739927244/videos/326344388635144/?_so=_channel_tab&_rv=_all_videos_card. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Gjilanit me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun <https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/361517905223444/>. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020); Dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit me përkrahjen e IKD dhe INPO. Shih linkun <https://www.facebook.com/KosovoLawInstitute/videos/3235949023167360/>. (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2020).

Me këtë rast, qytetarët që kanë qenë pjesë e këtyre dëgjimeve buxhetore, kanë pasur mundësi që nga kryesuesi i kuvendit komunal apo përfaqësuesit e partive politike, të përfaqësuara në kuvendin komunal të komunës përkatëse, të kërkojnë sqarime apo edhe të parashtrojnë kërkesa buxhetore, për të cilat kërkesa, është diskutuar gjatë këtyre dëgjimeve publike.

Përtej kësaj, me qëllim të rritjes së përfshirjes qytetare në këto dëgjime publike, IKD dhe INPO kanë mundësuar për të gjithë qytetarët që të shtrojnë pyetje përmes rrjetit social “Facebook” drejtpërdrejtë kur po zhvilloheshin dëgjimet, si dhe përmes e-mail adresës së vënë në dispozicion paraprakisht, ku pastaj për të njëjtat pyetje është kërkuar përgjigje nga zyrtarët komunal. Përmes e-mailit apo komenteve në facebook, janë pranuar rreth 18 kërkesa lidhur me çështje dhe nevoja të ndryshme në komuna.

Kjo mënyrë e organizimit të dëgjimeve, përveç se ka qenë e përshtatshme duke marrë parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, vlerësojmë që është shumë efektive për t’u organizuar edhe në të ardhmen. Në këtë mënyrë, edhe ata qytetarë që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në takim për shkak të angazhimeve ditore, mund të bëhen pjesë direkte apo indirekte e diskutimit online.

10. Miratimi dhe publikimi i buxhetit

Neni 20.3. i Ligjit Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se “...Data në të cilën komunat duhet t’i përfundojnë dhe dorëzojnë propozim-buxhetet dhe kërkesat e tyre për ndarje buxhetore është 30 Shtatori i atij viti...”.

Me këtë rast, siç u trajtua paraprakisht, përkundër faktit se kuvendet komunale të komunave të monitoruara nuk e kanë pranuar propozim-buxhetin ashtu siç kërkohet me ligj, të gjitha Kuvendet Komunale kanë arritur që buxhetin ta miratojnë brenda afatit ligjor, përjashtimisht Komunës së Prishtinës, Kuvendi Komunal i së cilës buxhetin e ka miratuar jashtë afatit ligjor.

Data e miratimit të buxhetit komunal	
Komuna	Data e miratimit të buxhetit
Prishtinë	2 tetor 2020
Pejë	30 shtator 2020
Gjakovë	29 shtator 2020
Gjilan	29 shtator 2020
Vushtrri	24 shtator 2020

Rahovec	29 shtator 2020
Deçan	25 shtator 2020
Junik	29 shtator 2020
Hani i Elezit	30 shtator 2020

Tabela 17: Data e miratimit të buxhetit komunal.

Pas miratimit të buxhetit komunal, IKD dhe INPO kanë monitoruar edhe publikimin e buxhetit komunal nga nëntë (9) komunat e përzgjedhura.

Në këtë drejtim, Komuna e Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Vushtrrisë, Rahovecit, Deçanit dhe Hanit të Elezit e kanë publikuar buxhetin komunal, derisa Komuna e Junikut nuk e ka bërë këtë.

Publikimi i buxhetit të miratuar	
Komuna	Publikimi i buxhetit
Prishtinë	✓
Pejë	✓
Gjakovë	✓
Gjilan	✓
Vushtrri	✓
Rahovec	✓
Deçan	✓
Junik	X ²¹
Hani i Elezit	✓

Tabela 18: Publikimi i buxhetit të miratuar.

²¹ Sqarim: Komuna e Junikut ka publikuar Planifikimin e Ndarjeve Buxhetore për vitin 2021 dhe jo buxhetin si tërësi. Dokumentin e publikuar nga komuna e Junikut mund ta gjeni në linkun në vijim: <https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2020/12/Plani-i-ndarjeve-buxhetore-per-vitin-2021.pdf>.

II. Kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve në dëgjimet buxhetore


Pas përfundimit të procedurave të buxhetimit në të gjitha komunat e monitoruara, IKD dhe INPO kanë analizuar të gjitha kërkesat e qytetarëve, të cilat janë paraqitur në dëgjimet buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i komunës përkatëse dhe dëgjimet buxhetore të mbajtura nga kuvendet komunale të komunave përkatëse.

Me këtë rast, IKD dhe INPO kanë nxjerrë edhe prioritetet e qytetarëve në komunat përkatëse.

Në vijim të këtij raporti, për secilën komunë të monitoruar, këto prioritetet janë paraqitur në formë të infografikave, derisa kërkesat e qytetarëve sipas qytetit, vendbanimit dhe llojit, përfshirë edhe nivelin e përfshirjes së kërkesave në buxhetin e miratuar të komunës përkatëse janë paraqitur në Annexin I të këtij raporti.



Infografika I: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2021.



Infografika 2: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2021.



Infografika 3: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2021.



Infografika 4: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Gjilanit për vitin 2021.



Infografika 5: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2021.




Infografika 6: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2021.



Infografika 7: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Deçanit për vitin 2021.



Infografika 8: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Junikut për vitin 2021.



Infografika 9: Kërkesat e qytetarëve për përfshirje në buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.

12. Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar të komunës

IKD dhe INPO kanë analizuar edhe përfshirjen dhe mospërfshirjen e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar nga komuna përkatëse, të cilat janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Në këtë drejtim, IKD dhe INPO kanë identifikuar numër të madh të projekteve të paraqitura në buxhetet e këtyre nëntë (9) komunave, të cilat nuk ofrojnë kurrfarë garancie se kërkesat e qytetarëve janë përfshirë në buxhet dhe se të njëjtat do të realizohen. Në të gjitha këto raste, projektet në buxhet janë të paraqitura në mënyrë shumë të përgjithësuar, për këtë arsye edhe janë kategorizuar në një grup të veçantë (nuk mund të identifikohen).

Në këtë drejtim, Komuna e Vushtrrisë ka numrin më të madh të kërkesave të qytetarëve, të cilat IKD dhe INPO nuk ka pasur mundësi t'i identifikojë, për shkak të mungesës së specifikimeve dhe paqartësive në buxhetet e miratuar²². Me këtë rast 205 nga 263 kërkesat e paraqitura, apo 77.94% të tyre, janë të kësaj natyre.

Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar					
Komuna	Nr. i kërkesave buxhetore	Të përfshira	Pjesërisht të përfshira	Të pa përfshira	Nuk mund të identifikohet
Hani i Elezit	26	3	0	10	13
Gjakovë	41	27	0	12	2
Rahovec	226	88	0	39	99
Gjilan	14	2	0	5	7
Vushtrri	263	3	0	55	205
Prishtinë	15	3	1	7	4
Pejë	213	3	0	93	117
Deçan	10	1	1	5	3
Junik	8	0	0	4	4

Tabela 19: Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në buxhetin e miratuar.

²² Shënim: Një shembull hipotetik i kësaj paqartësie është kur psh. kërkesa e qytetarit ka qenë: Kubëzimi i rrugës x, ndërsa buxheti ka paraparë: kubëzimin e rrugëve. Në këtë rast, nuk specifikohet nëse bëhet fjalë për kubëzimin e rrugës x apo të ndonjë rruge tjetër, kështu që nuk mund të konkludohet që një kërkesë e tillë është përfshirë në buxhet apo jo.

Ndërsa, sa përket bilancit të projekteve të komunës në mes të projekteve që kanë target qytetarët dhe projekteve që i referohen administratës, IKD dhe INPO gjejnë se komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës prijnë me numrin më të madh të projekteve të parapara për qytetarë. Kjo është e nënkuptueshme për faktin se këto dy (2) komuna edhe si total kanë numrin më të madh të projekteve, siç pasqyrohet në tabelën më poshtë.

Por, nëse i trajtojmë projektet për qytetarë dhe ato për administratë sipas vlerës totale të secilës prej këtyre dy (2) kategorive, dhe përqindjes së ndarjes buxhetore në këto dy (2) kategori sipas totalit të buxhetit për investimet kapitale, atëherë shohim se më së shumti Komuna e Hanit të Elezit e ka orientuar buxhetin për investime kapitale për projekte për qytetarë, përkatësisht 100% të buxhetit komunal, derisa Komuna e Junikut 49.78% të buxhetit për investime kapitale e ka orientuar për projekte kapitale për qytetarë, ndërsa pjesën tjetër për projekte për administratë. Në tabelën në vijim janë të dhënat për secilën komunë.

Bilanci i projekteve komunale për qytetarë/ për administratë.			
Komuna	Projekte për qytetarë	Projekte për administratë	Përqindja e buxhetit të projekteve për qytetarë, në raport me buxhetin total për investime kapitale
Prishtinë	98 (28,082,837€)	6 (510,000€)	94.23%
Deçan	26 (2,356,703€)	1 (150,000€)	94.02%
Rahovec	80 (4,263,979€)	3 (23,000€)	99.46%
Gjakovë	84 (7,677,302€)	2 (125,000€)	98.40%
Hani i Elezit	24 (440,127€)	0	100%
Gjilan	26 (5,951,743€)	2 (315,000€)	94.97%
Pejë	37 (7,732,226€)	4 (265,000€)	96.69%
Vushtrri	55 (4,029,154€)	3 (30,000€)	99.26%

Junik	6 (79,305€)	1 ²³ (80,000€)	49.78%
--------------	----------------	------------------------------	--------

Tabela 20: Bilanci i projekteve komunale për qytetarë/ për administratë.

IKD dhe INPO kanë analizuar edhe projektet komunale për nga aspekti se cilat nga to kanë qenë projekte të reja të përfshira në buxhet dhe sa të tjera kanë qenë vazhdim nga vitet paraprake²⁴.

Në këtë drejtim, shprehur në përqindje sipas totalit të numrit të projekteve, përqindjen më të lartë të projekteve të reja në raport me numrin total të projekteve komunale e ka Komuna e Prishtinës, 55.77% e projekteve të së cilës komunë janë projekte të reja, derisa në Komunën e Gjilanit vetëm 3.57% e projekteve komunale janë projekte të reja.

Bilanci projekt i ri/ vazhdim i projekteve komunale.			
Komuna	Projekt i ri	Vazhdim nga vitet paraprake	Përqindja e projekteve të reja
Prishtinë	58	46	55.77%
Pejë	8	34	19.05%
Gjakovë	41	45	47.67%
Gjilan	1	27	3.57%
Vushtrri	32	26	55.17%
Rahovec	16	67	19.28%
Deçan	11	16	40.74%
Junik	1	6	14.29%
Hani i Elezit	10	14	41.67%
Gjithsej	178	280	38.86%

Tabela 21: Bilanci projekt i ri/ vazhdim i projekteve komunale.

²³ Sqarim: Në këtë projekt përfshihet ngritja e kapaciteteve shërbyese, infrastrukturore, dhe shëndetësore.

²⁴ Sqarim: IKD dhe INPO ka identifikuar projektet si të reja, në çdo rast kur ky projekt ka filluar në vitin 2021 dhe nuk ka qenë i paraparë si projekt në vitin paraprak, atë 2020.

13. Gjetjet kryesore të IKD/INPO në procesin e buxhetimit komunal

Në vijim, IKD dhe INPO kanë paraqitur gjetjet kryesore të këtij raporti, i cili raport është rezultat i monitorimit të procesit të buxhetimit të nëntë (9) komunave.

- Konsultimi me shkrim dhe ai elektronik, si një nga standardet minimale të procesit të konsultimit publik me rastin e hartimit të Draft-Buxhetit është pothuajse formë e pazbatuar e konsultimit. Përkundër faktit se ky lloj i konsultimit paraqitet si obligativ, nga nëntë komunat e monitoruara, i njëjti është aplikuar vetëm nga Komuna e Vushtrrisë, si formë e vetme e konsultimit publik me rastin e hartimit të Draft-Buxhetit Komunal. Ndërsa, me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, asnjë prej komunave nuk ka zhvilluar këtë formë obligative të konsultimit publik.
- Procesi i konsultimeve publike përmes publikimit të njoftimit dhe Draft-Buxhetit në faqen zyrtare të komunës përkatëse dhe në platformën e konsultimeve publike vazhdon po ashtu të mbetet sfiduese për komunat.
- Nga monitorimi që IKD dhe INPO i ka bërë procesit të buxhetimit në komunat përkatëse, ka gjetur se nga nëntë (9) komunat e monitoruara, vetëm Komuna e Hanit të Elezit ka publikuar Draft-Buxhetin Komunal në faqet e saj zyrtare, para se i njëjti të procedohet në Kuvend Komunal, derisa tetë (8) komunat e tjera nuk e kanë bërë këtë.
- Pjesa tjetër e këtij obligimi të procesit të hartimit të buxhetit komunal, publikimi i njoftimit dhe Draft-Buxhetit në platformën e konsultimeve publike nuk është zbatuar nga asnjëra nga nëntë (9) komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO.
- Në rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, obligimin për të publikuar draft dokumentin, njoftimin për konsultime publike dhe adresën e dërgimit të komenteve në faqen zyrtare dhe platformën e konsultimeve publike e kanë përmbushur pjesërisht vetëm Komuna e Pejës dhe ajo e Rahovecit, derisa këtë obligim nuk e kanë përmbushur shtatë (7) komunat e tjera të monitoruara nga IKD dhe INPO.
- Sa i përket dëgjimeve buxhetore gjatë hartimit të propozim-buxhetit nga ekzekutivi i komunës përkatëse, nga nëntë (9) komunat e monitoruara nga IKD dhe INPO, pesë (5) prej tyre kanë mbajtur dëgjime buxhetore, derisa katër (4) komuna të tjera nuk e kanë zhvilluar këtë formë të konsultimeve publike me rastin e hartimit të buxhetit komunal. Ndërsa, sa i përket takimeve publike me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se katër (4) nga nëntë (9) komunat e monitoruara kanë mbajtur nga një (1) takim publik, derisa këtë nuk e kanë bërë pesë (5) komunat e tjera.

- Sa i përket pesë (5) komunave të cilat kanë mbajtur dëgjime buxhetore gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2021, Komuna e Rahovecit i ka organizuar 15 dëgjime buxhetore, Komuna e Pejës nëntë (9) dëgjime buxhetore, Komuna e Gjakovës gjashtë (6) dëgjime buxhetore, Komuna e Prishtinës pesë (5) dëgjime buxhetore ndërsa Komuna e Hanit të Elezit e ka organizuar një (1) dëgjim buxhetor.

- Për dallim nga ekzekutivi i komunave, Kuvendet Komunale të nëntë (9) komunave të monitoruara nga IKD dhe INPO kanë mbajtur dëgjime buxhetore lidhur me Draft Buxhetin Komunal, ku tetë (8) prej këtyre komunave, këto dëgjime buxhetore i kanë organizuar në bashkëpunim me IKD dhe INPO, në kuadër të projektit *“Kërkesa për Komuna Transparente dhe Llogaridhënëse: Monitorimi i prokurimit publik dhe fuqizimi i qytetarëve për të sjellë ndryshime pozitive”*.

- Sa i përket organizimit të këtyre dëgjimeve buxhetore, Komuna e Prishtinës dëgjimet buxhetore i ka ndarë sipas temës së diskutimit, Komuna e Pejës i ka organizuar sipas lokalitetit, kurse, ajo e Hanit të Elezit dëgjimin e vetëm buxhetor e ka organizuar si të hapur për të gjithë qytetarët. Kurse, Komuna e Gjakovës i ka mbajtur dëgjimet buxhetore sipas temës së diskutimit dhe po ashtu edhe të hapura, përderisa Komuna e Rahovecit dëgjimet buxhetore i ka organizuar sipas lokalitetit dhe po ashtu sipas temës së diskutimit. Ndërsa, të gjitha takimet publike të komunave gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore kanë qenë të hapura.

- Në dëgjimet buxhetore gjatë draftimit të buxhetit komunal dhe takimet publike gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, si aspekt shumë sfidues evidentohet pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në këto dëgjime publike.

- Sfidë tjetër shumë e madhe në këto dëgjime buxhetore dhe takime publike përbën përfaqësimi i ulët gjinor tek pjesëmarrësit, ku kemi numër jashtëzakonisht të ulët të grave pjesëmarrëse.

- Në dëgjimet buxhetore gjatë hartimit të buxhetit nga ekzekutivi i komunës përkatëse, IKD dhe INPO kanë gjetur se Kryetari i Komunës ka marrë pjesë vetëm në dëgjimet buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit, derisa Nënkryetari i komunës ka marrë pjesë në dëgjimet buxhetore të Komunës së Pejës, ndërsa në dëgjimet buxhetore të organizuara në pesë (5) komunat e monitoruara, në secilin rast, ka marrë pjesë Drejtori për Buxhet dhe Financa. Sa i përket takimeve publike gjatë draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, IKD dhe INPO gjejnë se në takimet publike të organizuara nga Komuna e Pejës, Junikut dhe Hanit të Elezit ka marrë pjesë Kryetari i Komunës, në ato të Pejës dhe Rahovecit ka marrë pjesë edhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal, derisa në secilin takim publik të organizuar nga komunat ka marrë pjesë Drejtori për Buxhet dhe Financa.

- Kërkesa e Ministrisë së Financave e datës 26 gusht 2020 për mosprocedim me Draft-Buxhetin Komunal deri në pranimin e qarkores buxhetore nga Ministria e Financave,

e cila qarkore është dërguar nga kjo ministri më 14 shtator 2020, ka ngushtuar kohën e Kuvendeve Komunale për diskutim dhe shqyrtim të Draft-Buxhetit Komunal, përfshirë edhe vështirësitë e krijuara për Kuvendet Komunale në organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë. Për më tepër, në rastin e Komunës së Prishtinës, kjo kërkesë e Ministrisë së Financave ka ndikuar që kjo komunë të miratojë buxhetin komunal pas përfundimit të afatit të përcaktuar me ligj.

- Pas miratimit të buxhetit komunal, tetë (8) prej komunave të monitoruara e kanë publikuar buxhetin komunal në faqen e tyre zyrtare, derisa Komuna e Junikut nuk e ka bërë këtë.
- Nga monitorimi i kërkesave të qytetarëve dhe përfshirjes ose jo të tyre në buxhet, IKD dhe INPO kanë gjetur se në shumicën e rasteve është e vështirë të identifikohet nëse një kërkesë e qytetarëve është përfshirë apo jo, për shkak të formës së përgjithshme se si paraqiten projektet komunale në buxhet, duke mos ofruar kështu kurrfarë garancie se kërkesat e qytetarëve janë përfshirë në buxhet dhe se të njëjtat do të realizohen.
- Numri i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në buxhetin komunal ka qenë i ulët, madje nga nëntë (9) komunat e monitoruara, është evidentuar një komunë, e cila nuk ka përfshirë asnjë kërkesë të qytetarëve në buxhetin e saj komunal.
- Njëkohësisht, në disa raste edhe kërkesat e qytetarëve kanë qenë të paraqitura në formë jashtëzakonisht të përgjithëshme, gjë që pamundëson identifikimin e përfshirjes së tyre në buxhet.
- Nga nëntë (9) komunat e monitoruara, të gjitha kanë të përfshirë numër më të madh të projekteve që i dedikohen qytetarëve, në raport me numrin e projekteve që i referohen administratës komunale. Por, nëse i trajtojmë projektet për qytetarë dhe ato për administratë sipas vlerës totale të secilës prej këtyre dy (2) kategorive, dhe përqindjes së ndarjes buxhetore në këto dy (2) kategori sipas totalit të buxhetit për investimet kapitale, atëherë shohim se më së shumti Komuna e Rahovecit e ka orientuar buxhetin për investime kapitale për projekte për qytetarë, përkatësisht 99.46% të buxhetit komunal, derisa Komuna e Junikut 49.78% të buxhetit për investime kapitale e ka orientuar për projekte kapitale për qytetarë, ndërsa pjesën tjetër për projekte për administratë.
- Dy (2) nga nëntë (9) komunat e monitoruara kanë më shumë projekte të reja, sesa të tilla që janë vazhduar nga vitet paraprake. Shtatë (7) komuna të tjera kanë më shumë projekte vazhdim nga vitet paraprake, në mesin e të cilave edhe Komuna e Gjilanit, e cila ka vetëm një (1) projekt të ri në buxhetin e vitit 2021.

14. Rekomandime

1. Nëntë (9) komunat e monitoruara të zbatojnë obligimin e mbajtjes së konsultimit me shkrim dhe elektronik me rastin e draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore. Po ashtu, këto komuna të zbatojnë obligimin për publikimin e Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore, njoftimit për konsultim publik, afatin dhe adresën zyrtare për dërgimin e komenteve në faqen zyrtare të komunave dhe platformën e konsultimeve publike.
2. Komuna e Prishtinës, Vushtrrisë, Gjakovës, Gjilanit dhe Deçanit të organizojnë takime publike gjatë fazës së draftimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore.
3. Ekzekutivi i Komunës së Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Rahovecit, Deçanit, Junikut dhe Hanit të Elezit të zhvillojnë procesin e konsultimit publik me shkrim dhe elektronik në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna me rastin e hartimit të buxhetit komunal për vitin pasues. Në drejtim të zbatimit të këtij obligimi, komunat duhet të publikojnë 1) projekt-propozimin, 2) adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet, 3) informata mbi personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe 4) afatin për dorëzimin e komenteve. Me këtë rast, komunat krahas faqes së tyre zyrtare, këto informata t'i publikojnë edhe në platformën e konsultimeve publike. Afati i konsultimit publik si në këtë mënyrë të jetë të paktën 15 ditë pune, i cili afat duhet të përfundojë më së largu deri më 15 gusht të vitit përkatës, në mënyrë që nga kjo datë e deri më 1 shtator të vitit përkatës, ekzekutivi i komunës përkatëse të ketë mundësi t'i shqyrtojë këto kërkesa buxhetore.
4. Në secilin rast, ekzekutivi i komunave të organizojë dëgjime buxhetore. Përkundër faktit se me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna përcaktohet obligimi i ekzekutivit të komunave që të mbajë të paktën një (1) dëgjim publik, IKD dhe INPO rekomandojnë që paraprakisht, komunat të hartojnë një plan të dëgjimeve buxhetore, në mënyrë që këto dëgjime të përfshijnë sa më shumë qytetarë dhe të ketë shtrirje në të gjitha fshatrat, lagjet, vendbanimet dhe zonat urbane. Ky plan të përshtatet varësisht specifikave të një (1) komune të caktuar dhe të synojë gjithëpërfshirje të qytetarëve në procesin e buxhetimit, duke marrë përsipër lehtësimet maksimale për qytetarë, për pjesëmarrjen e të njëjtëve në këto dëgjime buxhetore.
5. Nisur nga fakti se për shkak të gjendjes së krijuar me pandeminë COVID-19 mbajtja fizike e dëgjimeve buxhetore paraqet rrezik për shëndetin publik, komunat të organizojnë dëgjimet buxhetore në mënyrë virtuale dhe në faqet e tyre të ofrojnë informata të thjeshtëzuara apo video të shkurtër informuese lidhur me aspektet teknike mbi mënyrën e qasjes në këto dëgjime buxhetore virtuale.

6. Të gjitha komunat të paraqesin në faqet e tyre zyrtare informata lehtë të qasshme mbi të drejtën dhe mundësinë e qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjime publike.
7. Komuna e Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Hanit të Elezit, Vushtrrisë, Deçanit, Gjakovës dhe Junikut të hartojnë dhe publikojnë raportet e konsultimeve publike lidhur me draftimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, ashtu siç kërkohet me nenin 5.5. të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.
8. Raporti i konsultimeve publike për dëgjimet e projekt buxhetit të hartohet dhe publikohet nga komunat e Prishtinës, Deçanit, Junikut, Gjilanit, Hanit të Elezit, dhe Pejës.
9. Komunat inkurajohen të aplikojnë edhe format e tjera të konsultimit publik, jo obligative sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.
10. Komunat të angazhohen që të ofrojnë forma dhe metoda të ndryshme të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, të tilla që mundësojnë pjesëmarrje sa më të madhe të grave.
11. Kuvendet Komunale të jenë proaktive dhe të zbatojnë obligimet ligjore për konsultim publik me qytetarët në fazën e shqyrtimit të propozim-buxhetit. Në planin e tyre të punës, Kuvendet Komunale të planifikojnë mbajtjen e dëgjimeve buxhetore sipas specifikave të komunës përkatëse, në mënyrë që këto dëgjime buxhetore të kenë shtrirje sa më të madhe.
12. Komuna e Junikut të publikojë buxhetin e miratuar për vitin 2021.
13. Komunat e monitoruara të angazhohen që projektet e përfshira në buxhet të kenë emërtime konkrete dhe jo të përgjithshme, me qëllim që qytetarët ta kenë të qartë se cilat janë investimet dhe projektet që priten të realizohen sipas buxhetit të vitit përkatës.

15. Shtojca I – Kërkesat e qytetarëve gjatë draftimit të KAB-it komunal, sipas vendbanimit dhe llojit

Në këtë pjesë të raportit, IKD dhe INPO kanë paraqitur numrin e kërkesave të parashtruara nga qytetarët me rastin e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore nga komunat e monitoruara.

Të dhënat si më poshtë përfshijnë numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve, si dhe nivelin e përfshirjes së të njëjtave në KAB-in e miratuar nga komuna përkatëse. Takimet publike përkitazi me draftimin e KAB-it janë organizuar si të hapura, por duke u bazuar në karakterin e kërkesave, IKD dhe INPO kanë paraqitur kërkesat edhe sipas vendbanimit përkatës.

Po ashtu, IKD dhe INPO në këtë pjesë kanë paraqitur të dhëna edhe mbi numrin e kërkesave të qytetarëve, të ndara sipas kategorive, si dhe nivelin e përfshirjes²⁵ së të njëjtave në KAB-in e miratuar nga komuna përkatëse.

15.1. Komuna e Hanit të Elezit

Bazuar në paraqitjen konkrete të kërkesave të qytetarëve, tabela në vijim pasqyron numrin e tyre sipas vendbanimeve të Komunës së Hanit të Elezit, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në KAB-in e miratuar nga Komuna e Hanit të Elezit:

Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit dhe përfshirja e tyre në KAB sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në KAB-in miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve sipas përqindjes
Seçishtë	2	0	0	2	00.00%
Laç	1	0	0	1	00.00%
Lagjja Meliq	2	0	0	2	00.00%

²⁵ Këto tabela nuk paraqesin informata lidhur me kërkesat të cilat nuk janë përfshirë në KAB.

Zona urbane	2	1	0	0	50.00%
Tjetër	1	0	0	0	00.00%
TOTAL	8	1	0	5	12.50%

Tabela 22: Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit dhe përfshirja e tyre në KAB sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Hanit të Elezit gjatë draftimit të KAB-it sipas llojit të kërkesave të qytetarëve, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në KAB-in e miratuar nga Komuna e Hanit të Elezit:

Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në KAB-in miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve sipas përqindjes
Rrugë	3	0	0	3	00.00%
Kanalizim	1	0	0	1	00.00%
Infrastrukturë	2	0	0	1	00.00%
Ambient	2	1	0	0	50.00%
TOTAL	8	1	0	5	12.50%

Tabela 23: Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit sipas llojit të kërkesës.

15.2. Komuna e Junikut

Bazuar në paraqitjen konkrete të kërkesave të qytetarëve, tabela në vijim pasqyron numrin e tyre sipas vendbanimeve të Komunës së Junikut, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në KAB-in e miratuar nga Komuna e Junikut:

Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Junikut dhe përfshirja e tyre në KAB sipas vendbanimit

Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në KAB-in e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve sipas përqindjes
Zona Rurale	1	1	0	0	100.00%
Rodosh	1	0	0	1	00.00%
Qytet	1	0	0	1	00.00%
Tjera	1	0	0	0	00.00%
TOTAL	4	1	0	2	25.00%

Tabela 24: Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Junikut dhe përfshirja e tyre në KAB sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Junikut gjatë draftimit të KAB-it sipas llojit të kërkesave të qytetarëve, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në KAB-in e miratuar nga Komuna e Junikut:

Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Junikut sipas llojit të kërkesës

Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në KAB-in e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në KAB-in miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve sipas përqindjes
Kanal i ujitjes	1	0	0	1	00.00%
Mbyllje e kanalit	1	0	0	1	00.00%
Shtigje për çiklizëm, hiking dhe shtigje të ecjes malore	1	1	0	0	100.00%
Subvencione	1	0	0	0	00.00%
TOTAL	4	1	0	2	25.00%

Tabela 25: Kërkesat e qytetarëve të Komunës së Junikut sipas llojit të kërkesës.

16. Shtojca II – Kërkesat buxhetore të qytetarëve sipas vendbanimit dhe llojit

Në këtë pjesë të raportit, IKD dhe INPO kanë paraqitur numrin e kërkesave buxhetore të parashtruara nga qytetarët me rastin e hartimit të buxhetit nga komunat e monitoruara.

Të dhënat si më poshtë përfshijnë numrin e kërkesave buxhetore sipas vendbanimeve, si dhe nivelin e përfshirjes së të njëjtave në buxhetin e miratuar nga komuna përkatëse.

Po ashtu, IKD dhe INPO në këtë pjesë kanë paraqitur të dhëna edhe mbi numrin e kërkesave buxhetore, të ndara sipas kategorive, si dhe nivelin e përfshirjes²⁶ së të njëjtave në buxhetin e miratuar nga komuna përkatëse.

16.1. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës nuk i ka ndarë dëgjimet buxhetore sipas lokacionit, por sipas temës së diskutimit.

Megjithatë, bazuar në paraqitjen konkrete të kërkesave të qytetarëve, tabela në vijim pasqyron numrin e tyre sipas vendbanimeve të Komunës së Prishtinës, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Prishtinës:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Prishtinës dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. kërkesave të qytetarëve	Nr. kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Barilevë	1	0	0	0	0.00%
Slivovë	1	1	0	0	100.00%
Qytet	12	2	1	4	16.67%
Tjetër	1	0	0	0	0.00%
TOTAL	15	3	1	4	20.00%

Tabela 26: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Prishtinës dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit.

²⁶ Këto tabela nuk paraqesin informata lidhur me kërkesat të cilat nuk janë përfshirë në buxhetin e miratuar.

Në total, gjatë procesit të buxhetimit në Komunën e Prishtinës janë pranuar gjithsej 15 kërkesa buxhetore nga qytetarët, tri (3) prej të cilave janë përfshirë në buxhetin e miratuar nga Komuna e Prishtinës, që përbën 20% të totalit të kërkesave buxhetore të parashtruara nga qytetarët.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Prishtinës sipas llojit të kërkesave buxhetore si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Prishtinës:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Prishtinës dhe përfshirja e tyre sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	3	0	1	2	0.00%
Barazi gjinore	1	0	0	0	0.00%
Bujqësi	1	1	0	0	100.00%
Ekonomi	1	0	0	0	0.00%
Kanalizim	1	0	0	0	0.00%
Ndriçim publik	1	0	0	1	0.00%
Ngrohje qendrore	1	0	0	1	0.00%
Parqe	1	0	0	0	0.00%
Shëndetësi	1	0	0	0	0.00%
Transport publik	1	0	0	0	0.00%
Të tjera	3	2	0	0	66.67%
TOTAL	15	3	1	4	20.00%

Tabela 27: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Prishtinës sipas llojit të kërkesës.

16.2. Komuna e Gjakovës

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Gjakovës, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Gjakovës²⁷:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjakovës dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Qytet	15	10	0	1	66.67%
Koronicë, Devë, Guskë	2	2	0	0	100.00%
Ponoshec	5	3	0	0	60.00%
Planqor	1	1	0	0	100.00%
Skivjan	1	1	0	0	100.00%
Novosellë	3	2	0	1	66.67%
Dallashaj	1	0	0	0	0.00%
Brekoc	2	2	0	0	100.00%
Kralan	1	0	0	0	0.00%
Herec, Dujakë	1	1	0	0	100.00%
Qerim	1	1	0	0	100.00%
Gërqinë	1	1	0	0	100.00%
Molliq, Nivokaz, Dobrosh, Paqaj	1	1	0	0	100.00%

²⁷ Sqarim: IKD dhe INPO fillimisht kanë raportuar për vetëm 7 kërkesa të qytetarëve të përfshira në buxhetin e vitin 2021, 1 kërkesë të përfshirë pjesërisht, 15 të papërfshira, përderisa 18 kërkesa ka qenë e pamundur të identifikohen nëse janë përfshirë apo jo në buxhet, për shkak të emërimit të përgjithshëm. Megjithatë, pas dërgimit të raportit për komente tek të gjitha komunat, Komuna e Gjakovës ka kthyer me komente të gjitha kërkesat të cilat i kanë përfshirë në buxhet dhe rrjedhimisht tabelat në këtë pjesë përfshijnë klasifikimin e kërkesave pas adresimit të komenteve të pranura nga Komuna e Gjakovës.

Tjetër	6	2	0	0	33.33%
TOTAL	41	27	0	2	65.85%

Tabela 28: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjakovës dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Gjakovës sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Gjakovës:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjakovës sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	12	10	0	1	83.33%
Trotuar	3	3	0	0	100.00%
Kanalizim	3	3	0	0	100.00%
Kanalizimi i ujësjellës	2	2	0	0	100.00%
Sport	1	0	0	1	0.00%
Kulturë	1	0	0	0	0.00%
Rregullimi i urave	1	1	0	0	100.00%
Parkingje	1	1	0	0	100.00%
Ndriçim Publik	3	3	0	0	100.00%
Mbeturina	2	0	0	0	0.00%
Arsim	3	0	0	0	0.00%
Aeroporti	1	0	0	0	0.00%

Varreza	1	0	0	0	0.00%
Rinia	1	1	0	0	100.00%
Të moshuar	1	1	0	0	100.00%
Biznese	1	1	0	0	100.00%
Tjera	4	1	0	0	25.00%
TOTAL	41	27	0	2	65.85%

Tabela 29: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjakovës sipas llojit të kërkesës.

16.3. Komuna e Pejës

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Pejës, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Pejës:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Pejës dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Fshatrat e Lugit të Baranit, Raushiq dhe Lubeniq	14	0	0	11	0.00%
Fshatrat e Rugovës	40	2	0	23	5.00%
Fshatrat në Vitomericë	17	0	0	5	0.00%
Gorozhdec, Millovanc, Poqestë, Vragoc, Pishtan, Kerrstovc	14	0	0	9	0.00%
Llozhan, Graboc, Loxhë, Doberdolë	18	0	0	13	0.00%
Qyshk, Pavlan, Billagaj, Lutogllave, Llabjan, Trestnik, Ruhot, Nabergjan, Katundi i ri	39	0	0	29	0.00%

Qyteti	34	1	0	9	2.94%
Radavc, Novosellë, Jabllanicë e Madhe dhe Jabllanica e Vogël	37	0	0	18	0.00%
TOTAL	213	3	0	117	1.41%

Tabela 30: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Pejës dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Pejës sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Pejës:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Pejës sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	57	1	0	51	1.75%
Arsim	9	0	0	5	0.00%
Energji Elektrike	6	0	0	0	0.00%
Kanal i ujitjes	21	0	0	21	0.00%
Kanalizim	15	0	0	13	0.00%
Kënd lojrave	1	0	0	0	0.00%
Kulturë	4	0	0	2	0.00%
Mbeturina	3	0	0	0	0.00%
Mure mbrojtëse	5	0	0	5	0.00%
Ndërtim shesheve	2	0	0	0	0.00%
Ndriçim publik	19	0	0	0	0.00%

Parkingje	3	0	0	0	0.00%
Parqe	2	0	0	0	0.00%
Rinia	1	1	0	0	0.00%
Shpronësim	2	0	0	2	0.00%
Sport	5	0	0	5	0.00%
Trotuar	12	0	0	11	0.00%
Ujë i pijshëm	18	2	0	0	11.11%
Ura	2	0	0	0	0.00%
Të tjera	26	0	0	2	0.00%
TOTAL	213	3	0	117	1.41%

Tabela 31: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Pejës sipas llojit të kërkesës.

16.4. Komuna e Gjilanit

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Gjilanit, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Gjilanit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjilanit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. kërkesave të qytetarëve	Nr. kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Llasticë	2	0	0	2	0.00%
Bresalcë	4	0	0	3	0.00%
Cërnica	1	0	0	1	0.00%
Livoç	1	0	0	0	0.00%
Qytet	2	1	0	1	50.00%

Tjetër	4	1	0	0	25.00%
TOTAL	14	2	0	7	14.29%

Tabela 32: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjilanit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Gjilanit sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Gjilanit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjilanit sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Arsim	2	1	0	0	50.00%
Kanalizim	2	0	0	2	0.00%
Lumenjë/përroska	1	0	0	0	0.00%
Mbeturina	1	0	0	0	0.00%
Rrugë	1	0	0	1	0.00%
Trotuar	2	0	0	2	0.00%
Ujë i pijshëm	2	0	0	2	0.00%
Të tjera	3	1	0	0	33.33%
TOTAL	14	2	0	7	14.29%

Tabela 33: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Gjilanit sipas llojit të kërkesës.

16.5. Komuna e Vushtrrisë

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Vushtrrisë, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Vushtrrisë:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit

Vendbanimi	Nr. kërkesave të qytetarëve	Nr. kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Akrashticë	4	0	0	2	0.00%
Bajskë	1	0	0	0	0.00%
Beciq	5	0	0	4	0.00%
Becuk	2	0	0	2	0.00%
Begaj	5	0	0	2	0.00%
Bivolak	2	0	0	1	0.00%
Bukosh	5	0	0	4	0.00%
Bukosh i Epërm	1	0	0	1	0.00%
Ceceli	8	0	0	8	0.00%
Doberllukë	5	0	0	4	0.00%
Doluak	1	0	0	1	0.00%
Dominic e Ilugës	1	0	0	1	0.00%
Druar	6	0	0	5	0.00%
Duboc	3	0	0	3	0.00%
Dumnicë e Poshtme	8	0	0	8	0.00%
Dumnicë e Ulët	1	0	0	1	0.00%
Gllavotin	1	0	0	1	0.00%
Grac	1	0	0	1	0.00%
Karaq	1	0	0	1	0.00%

Kollë	1	0	0	1	0.00%
Maxhunaj	10	0	0	8	0.00%
Mihaliq	9	0	0	9	0.00%
Nadakovc	3	0	0	3	0.00%
Novolan	5	0	0	5	0.00%
Oshlan	1	0	0	1	0.00%
Pantina	5	0	0	5	0.00%
Pasomë	2	0	0	2	0.00%
Prelluzhë	2	0	0	2	0.00%
Reznik	19	1	0	17	0.00%
Ropicë	5	0	0	1	20.00%
Rruga "2 maji"	1	0	0	0	0.00%
Rruga Shaban Tahiri	2	0	0	2	0.00%
Rruga Ferat Novolani	1	0	0	1	0.00%
Rruga Lidhja e Lezhes	4	0	0	3	0.00%
Rruga Nijazi Badivuku	1	0	0	1	0.00%
Rruga Ana Lin	3	0	0	0	0.00%
Rruga Azem Bejta	1	0	0	1	0.00%
Rruga Dëshmorët e Kombit	1	0	0	0	0.00%
Rruga Ismail Qemali	4	0	0	1	0.00%
Rruga Ismet Haliti	1	0	0	0	0.00%
Samadrexhë	5	0	0	4	0.00%
Sfaraqak	1	0	0	1	0.00%
Sfaraqak Poshtëm	2	0	0	2	0.00%

Shalë	4	0	0	4	0.00%
Shallcë	1	0	0	1	0.00%
Shtitaricë	9	0	0	9	0.00%
Sllatinë	6	0	0	6	0.00%
Smrekonicë	9	0	0	9	0.00%
Stanovc/Stanoc i Epërm	12	0	0	12	0.00%
Stanoc i Ulët	2	0	0	1	0.00%
Strofc	1	0	0	1	0.00%
Studime	2	0	0	1	0.00%
Studime Eperme	4	0	0	4	0.00%
Studime e Ulët	3	0	0	2	0.00%
Vërnice	4	0	0	4	0.00%
Vilanc	1	0	0	0	0.00%
Zekolli	4	0	0	4	0.00%
Tjetër	51	2	0	27	3.92%
TOTAL	263	3	0	205	1.14%

Tabela 34: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Vushtrrisë sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Vushtrrisë:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë sipas llojit të kërkesës

Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	57	2	0	52	3.51%
Arsim	8	0	0	4	0.00%
Bujqësi	1	0	0	0	0.00%
Ekonomi	2	0	0	0	0.00%
Energji Elektrike	4	0	0	0	0.00%
Gjelbërim	5	0	0	5	0.00%
Kanalizim	32	0	0	30	0.00%
Lumenjë	1	0	0	1	0.00%
Mbeturina	4	0	0	0	0.00%
Ndriçim Publik	35	0	0	35	0.00%
Parkingje	2	0	0	0	0.00%
Parqe	2	1	0	0	50.00%
Pastrim i lumenjëve	2	0	0	2	0.00%
Rinia	3	0	0	0	0.00%
Semaforë	1	0	0	0	0.00%
Shëndetësi	13	0	0	7	0.00%
Sport	9	0	0	9	0.00%
Stacion i autobusave	2	0	0	2	0.00%
Të moshuar	1	0	0	0	0.00%

Trotuar	22	0	0	22	0.00%
Ujë pijshëm	34	0	0	33	0.00%
Ura	1	0	0	0	0.00%
Të tjera	22	0	0	3	0.00%
TOTAL	263	3	0	205	1.14%

Tabela 35: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë sipas llojit të kërkesës.

16.6. Komuna e Rahovecit

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Rahovecit, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Rahovecit²⁸:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Bratorin	7	2	0	4	28.57%
Brestoc	2	2	0	0	100.00%
Celinë	7	3	0	3	42.86%
Cifllak	7	4	0	3	57.14%
Dejnë	7	3	0	4	42.86%
Dobidol	12	3	0	5	25.00%

²⁸ Sqarim: IKD dhe INPO fillimisht kanë raportuar për vetëm 7 kërkesa të qytetarëve të përfshira në buxhetin e vitin 2021, 1 kërkesë të përfshirë pjesërisht, 50 të papërfshira, përderisa 168 kërkesa ka qenë e pamundur të identifikohen nëse janë përfshirë apo jo në buxhet, për shkak të emërimit të përgjithshëm. Megjithatë, pas dërgimit të raportit për komente tek të gjitha komunat, Komuna e Rahovecit ka kthyer me komente të gjitha kërkesat të cilat i kanë përfshirë në buxhet dhe rrjedhimisht tabelat në këtë pjesë përfshijnë klasifikimin e kërkesave pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Rahovecit.

Drenoc	6	4	0	1	66.67%
Fortesë	8	4	0	4	50.00%
Guri i Kuq	3	0	0	3	0.00%
Hoqë e Madhe	7	3	0	3	42.86%
Hoqë e Vogël	10	4	0	5	40.00%
Kramovik	6	1	0	4	16.67%
Lagjja I	12	3	0	3	25.00%
Lagjja II	6	5	0	1	83.33%
Lagjja III	6	5	0	1	83.33%
Lagjja IV	1	0	0	1	0.00%
Lagjja V	3	2	0	1	66.67%
Malësi e Vogël	10	3	0	5	30.00%
Mrasor	6	3	0	2	50.00%
Nagavc	4	1	0	2	25.00%
Opterushë	12	2	0	7	16.67%
Pastasellë	6	3	0	2	50.00%
Pataqan I Ulët	6	1	0	5	16.67%
Ratkoc	13	6	0	6	46.15%
Retijë e Poshtme	11	4	0	5	36.36%
Senoc	5	2	0	3	40.00%
Sopniq	5	2	0	2	40.00%
Vrajakë	4	2	0	2	50.00%
Xërxë	7	3	0	2	42.86%
Zatriq	7	2	0	5	28.57%

Zoqisht	5	2	0	3	40.00%
Tjetër	15	4	0	2	26.67%
TOTAL	226	88	0	99	38.94%

Tabela 36: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Rahovecit sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Rahovecit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Rahovecit sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. kërkesave të qytetarëve	Nr. kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	67	30	0	30	44.78%
Arsim	13	1	0	7	7.69%
Bujqësi	10	1	0	9	10.00%
Energji Elektrike	2	0	0	0	0.00%
Gjelbërim	5	1	0	4	20.00%
Kanal i ujitjes	2	0	0	0	0.00%
Kanalizim	24	20	0	3	83.33%
Kulturë	2	0	0	1	0.00%
Lumenjë/përroska	11	0	0	11	0.00%
Mbeturina	4	3	0	0	75.00%
Mure mbrojtëse	1	0	0	0	0.00%
Ndriçim Publik	20	13	0	7	65.00%

Parqe	7	0	0	6	0.00%
Rinia	2	1	0	0	50.00%
Shëndetësi	3	2	0	1	66.67%
Sport	10	1	0	6	10.00%
Të moshuar	1	0	0	0	0.00%
Trotuar	15	8	0	6	53.33%
Ujë i pijshëm	8	4	0	4	50.00%
Ura	2	1	0	0	50.00%
Të tjera	17	2	0	4	11.76%
TOTAL	226	88	0	99	38.94%

Tabela 37: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Rahovecit sipas llojit të kërkesës

16.7. Komuna e Deçanit

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2021, Komuna e Deçanit ka pranuar gjithsej dhjetë (10) kërkesa buxhetore, lidhur me të cilat tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Deçanit, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Deçanit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Deçanit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Zona rurale	5	1	0	3	20%
Tjetër	5	0	1	0	0.00%
TOTAL	10	1	1	3	10.00%

Tabela 38: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit

Ndërsa, prej këtyre dhjetë (10) kërkesave, vetëm një (1) prej tyre është përfshirë në buxhetin e miratuar nga Komuna e Deçanit, që përbën 10% të kërkesave buxhetore të qytetarëve.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Deçanit sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Deçanit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Deçanit sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Ujë i pijshëm	1	0	0	1	0.00%
Bujqësi	1	0	0	1	0.00%
Barazi Gjinore	1	0	0	0	0.00%
Kanal ujitjes	1	0	0	0	0.00%
Kanalizim	1	0	0	1	0.00%
Ndriçim publik	1	1	0	0	100.00%
Rinia	2	0	1	0	0.00%
Subvencione	1	0	0	0	0.00%
Teknologji	1	0	0	0	0.00%
TOTAL	10	1	1	3	10.00%

Tabela 39: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Deçanit sipas llojit të kërkesës.

16.8. Komuna e Junikut

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Junikut, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Junikut:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Junikut dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit

Vendbanimi	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Qendër	1	0	0	0	0.00%
Miroc	1	0	0	1	0.00%
Zona rurale	2	0	0	1	0.00%
Tjetër	4	0	0	2	0.00%
TOTAL	8	0	0	4	0.00%

Tabela 40: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Junikut dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2021, Komuna e Junikut ka pranuar gjithsej tetë (8) kërkesa buxhetore, dhe asnjë prej tyre nuk është përfshirë në buxhetin e miratuar nga Komuna e Junikut.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Junikut sipas llojit të kërkesave buxhetore.

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Junikut sipas llojit të kërkesës

Lloji i prioritetit	Nr. i kërkesave të qytetarëve	Nr. i kërkesave të përfshira në buxhetin miratuar	Nr. i kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin miratuar	Nr. i kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	4	0	0	4	0.00%
Kanalizim	1	0	0	0	0.00%
Barazi Gjinore	1	0	0	0	0.00%

Të tjera	2	0	0	0	0.00%
TOTAL	8	0	0	4	0.00%

Tabela 41: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Junikut sipas llojit të kërkesës.

16.9. Komuna e Hanit të Elezit

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve sipas vendbanimeve të Komunës së Hanit të Elezit, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Hanit të Elezit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit					
Vendbanimi	Nr. kërkesave të qytetarëve	Nr. kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Dromjak	1	0	0	1	0.00%
Gorancë	13	2	0	6	15.38%
Lagjia "Uji i thartë	1	0	0	0	0.00%
Lagjia e Re	1	0	0	0	0.00%
Lajç	4	0	0	3	0.00%
Pustenik	1	0	0	1	0.00%
Qytet	2	0	0	1	0.00%
Krivenik	1	1	0	0	100.00%
Tjetër	2	0	0	1	0.00%
TOTAL	26	3	0	13	11.54%

Tabela 42: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit dhe përfshirja e tyre sipas vendbanimit.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave të qytetarëve të Hanit të Elezit sipas llojit të kërkesave buxhetore, si dhe përfshirjen e këtyre kërkesave në buxhetin e miratuar nga Komuna e Hanit të Elezit:

Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit sipas llojit të kërkesës					
Lloji i prioritetit	Nr. kërkesave të qytetarëve	Nr. kërkesave të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave pjesërisht të përfshira në buxhetin e miratuar	Nr. kërkesave që nuk mund të identifikohen nëse janë përfshirë në buxhetin e miratuar	Niveli i përfshirjes së kërkesave buxhetore sipas përqindjes
Rrugë	5	1	0	4	20.00%
Arsim	2	0	0	2	0.00%
Energji Elektrike	1	0	0	0	0.00%
Gjelbërim	1	0	0	0	0.00%
Kanalizim	3	0	0	3	0.00%
Ndriçim publik	2	0	0	2	0.00%
Parkingje	1	0	0	0	0.00%
Parqe	2	0	0	0	0.00%
Sport	2	1	0	0	50.00%
Ujë i pijshëm	4	1	0	2	25.00%
Të tjera	3	0	0	0	0.00%
TOTAL	26	3	0	13	11.54%

Tabela 43: Kërkesat buxhetore të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit sipas llojit të kërkesës.

17. Shtojca III – Komentet e komunave të cilat nuk janë përfshirë në raport

17.1. Komuna e Hanit të Elezit

	Komenti i komunës	Sqarimi i IKD dhe INPO
1	Pastaj janë mbajtur dy dëgjime buxhetore, ku njëri është mbajtur nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal z. Qamush Brava, në formë virtuale përmes platformës Facebook. Ky dëgjim është mbajtur me datën 16.09.2020. Linku i procesverbalit: https://kk.rks-gov.net/haniiielezit/wp-content/uploads/sites/37/2020/09/PROCESI-I-DEBATIT-PUBLIK-PERMES-FESBUKUT.pdf	Ky dëgjim është mbajtur në kuadër të Kuvendit Komunal dhe jo si dëgjim buxhetor i ekzekutivit të komunës, andaj dhe nuk është përfshirë në tabelën ku i kemi evidentuar dëgjetimet buxhetore të mbajtura nga komuna e Hanit të Elezit. Ky dëgjim është i identifikuar në pjesën e poshtme të raportit, tek kapitulli 9 - Dëgjetimet buxhetore gjatë shqyrtimit të buxhetit në kuvendet komunale.
2	Në faqe 29 Tabela 9. Përfaqësimi gjinor në dëgjetimet buxhetore, sipas procesverbalit pjesëmarrëse gra kanë qenë 6, ndërsa burra kanë qenë 24, pra në total pjesëmarrës kanë qenë 30 pjesëmarrës.	Këtë e kemi adresuar në fusnotën nr.16, ku kemi treguar se numri i pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor, sa i përket qytetarëve, ka qenë 28. Kurse, dy (2) kanë qenë zyrtarë komunal.
3	Ju për Komunën e Hanit të Elezit keni shënuar që nga 26 kërkesa të qytetarëve vetëm 3 kërkesa janë të përfshira në buxhet, 13 nuk mund të identifikohen dhe 10 të papërfshira. Ne mendojmë që është gabim nga ana e juaj, sepse në projektet i kemi të miratuara kështu në forme të përgjithshme si: 1. Shtrimi me kubëza betoni në zonat urbane dhe rurale, 2. Rregullimi i kanalizimeve në zonën urbane dhe rurale,	IKD dhe INPO nuk kanë arritur të sigurojnë se ka më shumë se tre (3) kërkesa të qytetarëve të përfshira nga komuna e Hanit të Elezit në buxhet. Kjo për shkak se kërkesat e qytetarëve kanë qenë më specifike (p.sh. Shtrimi i rrugëve me kubëza betoni në Gorancë), ndërsa në buxhet parashihet vetëm si <i>Shtrimi me kubëza betoni nëpër zonë urbane dhe rurale të Hanit të Elezit</i>, që nuk garanton se do të

	3. Ndriçimi publik në zonën urbane dhe rurale, 4. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonën urbane dhe rurale, 5. Ndërtimi i trotuareve në zonën urbane dhe rurale. Dhe të gjitha kërkesat që kanë qenë të kësaj natyre, ne mendojmë që janë të përfshira në buxhet, prandaj mendojmë që duhet të ndryshoj përfshirja e kërkesave në buxhet nga 3 në 7.	bëhet shtrimi i rrugës pikërisht në p.sh. Gorancë.
4	Lidhur me publikimin e raportit të konsultimeve pas përmbylljes së procesit të konsultimeve publike, Komuna e Hanit të Elezit ka komentuar se komuna e ka publikuar një raport të tillë, i cili mund të gjindet në linqet: https://kk.rks-gov.net/haniiielezit/wp-content/uploads/sites/37/2020/08/Draft-Buxheti-2021-2023-Hani-i-Elezit.pdf https://kk.rks-gov.net/haniiielezit/wp-content/uploads/sites/37/2020/09/Procesverbal-i-d%C3%ABgjimit-t%C3%AB-dyt%C3%AB-publik.pdf	Komuna e ka cilësuar procesverbalin e dëgjimit buxhetor si raport të konsultimeve publike. IKD dhe INPO theksojnë faktin se procesverbalet nuk mund të konsiderohen raporte të konsultimeve publike. Këto të fundit duhet të sqarojnë tërësinë e një procesi të konsultimit publik, të listojnë kërkesat e qytetarëve dhe arsyet për refuzimin e kërkesave të caktuara.

17.2. Komuna e Gjakovës

Komenti i komunës		Sqarimi i IKD dhe INPO
I	Për kërkesën “Largimi i mbeturinave në Ponoshec”, Komuna ka dhënë këtë koment: <i>Ky projekt është në kompetencën e kompanisë rajonale të mbeturinave "Qabrati".</i>	Komuna nuk e ka konfirmuar përfshirjen e kësaj kërkeje, por vetëm ka dhënë sqarim shtesë.

2	Për kërkesën “Më shumë investime në Dallashaj, varrezat janë të stërmbushura të bëhet zgjidhje nga Komuna”, Komuna ka dhënë këtë koment: <i>Komuna ka paraparë mjete në projektin "Shpronësime" për të bërë pagesa të të shpronësimeve për tokën që përzgjedh me vendim Asambleja Komunale për këtë qëllim.</i>	Komuna nuk e ka konfirmuar përfshirjen e kësaj kërke, por vetëm ka dhënë sqarim shtesë.
3	Për kërkesën “Investime në Kralan, rruga Kralan – Gërgoc”, Komuna ka dhënë këtë koment: <i>Ky projekt është paraparë të realizohet në vitin 2022 dhe është në listën e projekteve kapitale "Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës Gërgoc - Kralan" mirëpo vetë banorët i kanë dhënë prioritet rrugëve të fshatit.</i>	Komuna nuk e ka konfirmuar përfshirjen e kësaj kërke në buxhetin e vitit 2021, por vetëm ka dhënë sqarim shtesë.
4	Për kërkesën “Aktivizimi i Zonës Ekonomike Amerikane si dhe Aeroportit të Gjakovës”, Komuna ka dhënë këtë koment: <i>Ky projekt është në kompetencë të Ministrisë së linjës.</i>	Komuna nuk e ka konfirmuar përfshirjen e kësaj kërke, por vetëm ka dhënë sqarim shtesë.
5	Për kërkesën “Përfshirja e shujtave të mësimdhënësve në buxhetin e vitit të ardhshëm”, Komuna ka dhënë këtë koment: <i>Realizimin e kësaj kërke nuk na e lejon Ligji i Buxhetit.</i>	Komuna nuk e ka konfirmuar përfshirjen e kësaj kërke, por vetëm ka dhënë sqarim shtesë.

17.3. Komuna e Rahovecit

Komenti i komunës		Sqarimi i IKD dhe INPO
I	Lidhur me mbajtjen e procesit të konsultimeve me shkrim, Komuna e Rahovecit ka thënë se ka mbajtur shënime gjatë dëgjimeve buxhetore.	Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, procesi i konsultimit me shkrim është formë e veçantë e konsultimit publik, e

		cila formë e konsultimit publik është po ashtu obligative.
2	Lidhur me rekomandimin Nr.1, Komuna e Rahovecit ka thënë se ka publikuar në dokumente të ndryshme për konsultime publike në platformën e konsultimeve publike.	Në platformën e konsultimeve publike, tek Komuna e Rahovecit, figurojnë disa dokumente komunale që janë lansuar në konsultim publik, por se asnjëra prej tyre nuk është Draft-Buxheti për vitin 2021, i cili dokument është objekt i këtij rekomandimi.
3	Lidhur me rekomandimin Nr.2 (tani rekomandimi Nr.3), Komuna e Rahovecit ka thënë se kanë përpiluar planin e konsultimeve publike, kalendarin e dëgjimeve publike, njoftimet për dëgjime publike dhe procesverbalet.	Përkundër faktit se Komuna e Rahovecit ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim, objekti kryesor i këtij rekomandimi ka të bëjë me ndërtimin e një plani të veçantë që përpos zbatimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, komunat të synojnë edhe ngritjen e përfshirjes së qytetarëve në procesin e konsultimeve publike.
4	Lidhur me rekomandimin Nr.4 (tani rekomandimi Nr.6) që kërkon nga komunat që në faqet e tyre të paraqesin informata lehtë të qasshme mbi të drejtën dhe mundësinë e qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjime publike, komuna ka dërguar linqet e faqes zyrtare të komunës që ofrojnë të dhëna mbi buxhetin.	Qëllimi i këtij rekomandimi nuk janë informatat mbi buxhetin, por informatat mbi të drejtën dhe mundësinë e qytetarëve për pjesëmarrje në procesin e buxhetimit komunal, publikimi i të cilave informata synon rritjen e përfshirjes së qytetarëve në këtë proces.